



**MANUAL GJYQËSOR PËR PARANDALIMIN
DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**



**MANUAL GJYQËSOR PËR PARANDALIMIN DHE
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Shkup,
2013

Manuali gjyqësor për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi u hartua në kuadër të Projektit: “Ndërtimi i kapaciteteve të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për implementimin e Strategjisë Nacionale për Barazi dhe Mosdiskriminim”. Projektin e implementon Këshilli Britanik në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, ndërkaq financiarisht mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Maqedonisë.

Botues:

Këshilli Britanik në Maqedoni

Autorë (sipas alfabetit):

Atanas Georgievski

Lençe Kocevaska

Dushko Minovski

Redaktore:

Mr. Elena Grozdanova

Recensent:

Dr. Zoran Mihajloski

Përktheu në shqip:

Dr. Blerina Starova - Zllatku

Disenji dhe shtypi:

“Datapons”

Tirazhi:

500

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.724.037(497.7)(035)

GEORGIEVSKI, Atanas

Manual gjyqësor për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi /
[autorë (sipas alfabetit) Atanas Georgievski, Lençe Kocevaska, Dushko
Minovski ; përktheu në shqip Blerina Starova-Zllatku]. - Shkup :
Këshilli Britanik në Maqedoni, 2013. - 46 стр. ; 24 см

Превод на делото: Судски прирачник за спречување и заштита од
дискриминација / Атанас Георгиевски, Ленче Коцевска, Душко Миновски.
- Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 46

ISBN 978-608-65560-0-6 (БСРМ)

1. Kocevaska, Lençe [автор] 2. Minovski, Dushko [автор]. - I.

Георгиевски, Атанас види Georgievski, Atanas. - II. Коцевска,

Ленче види Kocevaska, Lençe. - III. Миновски, Душко види Minovski, Dushko

а) Дискриминација - Спречување и заштита - Македонија - Прирачници

COBISS.MK-ID 93754378

Përmbajtja

Recension i Manualit gjyqësor për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi	5
Kapitulli i parë	9
Hyrje në diskriminim	10
Analizë e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi	11
Kapitulli i dytë	16
Mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi	17
Organet për mbrojtjen nga diskriminimi	18
Mbrojtja jashtë-gjyqësore	18
Mbrojtja gjyqësore	22
Kapitulli i tretë	33
Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me rastet e mbrojtjes nga diskriminimia	34

Lista e shkurtesave

KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
LPMD	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi
KP	Kodi Penal
KMD	Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
KB	Kombet e Bashkuara
RM	Republika e Maqedonisë

Recension i Manualit gjyqësor për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Fillimisht dua ta shpreh kënaqësinë time nga përpunimi i temës në fjalë në formë Manuali dhe së këtejmi, me publikimin e tij ai do të jetë i arritshëm për publikun më të gjerë. Pa dyshim se hartimi i një Manuali të këtillë paraqet një hap të vërtetë në mënyrë që më lehtë dhe më mirë të kuptohen dhe specifikohen problemet aktuale që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Autorët ia dolën që në mënyrë sukcesive dhe lapidare, megjithatë në mënyrë lehtësisht të pranueshme dhe narrative, t'i bëjnë një analizë Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, duke e vënë theksin mbi mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi të cilët paraqesin instrumente kryesore për realizimin e të drejtave të qytetarëve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Diskriminimi paraqet temë suptile dhe komplekse për të cilin në territorin tonë mund të flasin një numër i vogël njerëzish, meqë ai shfaqet në forma dhe trajta të ndryshme të cilat evoluojnë në mënyrë rapide dhe vështirë detektohen. Observimi dhe monitorimi i kësaj dukurie rezultojnë me një dimension jashtëzakonisht specifik të punës dhe paraqet sfidë të vërtetë për autorët të cilët arrijnë të ofrojnë një deskripsion të qartë për çështjen konkrete. Andaj, konsideroj se ky Manual do të stimulojë dhe do të arrijë ta animojë jo vetëm palën drejtpërdrejtë të prekur por edhe publikun profesional. Manualit një dimension të veçantë i jep edhe fakti se autorët janë anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili filloi me punë në vitin 2011.

Nga aspekti strukturor, Manuali Gjyqësor është ndarë në tri pjesë, të cilat vetvetiu paraqesin pjesë të veçanta, përkatësisht paraqesin tërësi konceptuale mirë të përpiluara.

Në pjesën e parë, autorët i përkufizojnë nocionet dhe përmbajtjet kryesore, të cilat rezultojnë nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Së këtejmi, vënë në dukje forma të ndryshme të diskriminimit: diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, shqetësimin, diskriminimin e personave me pengesa mendore dhe trupore, viktimizimin, diskriminimin gjatë sigurimit të pronës dhe shërbimeve, nxitjen dhe thirrjen për diskriminim dhe atë se çka nënkuptohet me forma më të rënda të diskriminimit. Në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi Republika e Maqedonisë “shkel” në një terren të ri dhe pamjaftueshëm të njohur, ndërsa hyrja në fuqi e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, nga viti 2010, krijoi një rrjet të tërë institucioneve dhe procedurash karakteristike për këtë çështje. Për shkak të kësaj autorët me të drejtë një pjesë të Manualit ia përkushtojnë kronologjisë dhe komponentit zhvillimor të aktorëve në procesin e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe promovimit të barazisë.

Në pjesën e dytë autorët në mënyrë thelbësore i trajtojnë mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi, organet kompetente (gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore) për mbrojtjen nga diskriminimi, procedurat, afatet, mekanizmat juridikë të cilët i kanë në dispozicion subjektet gjatë realizimit të të drejtave për mbrojtjen nga diskriminimi. Konsideroj se kjo është pjesa që do ta zgjojë interesimin e publikut profesional, meqë autorët sugjerojnë mundësinë për mbrojtjen nga diskriminimi përpara organeve jashtë-gjyqësore dhe gjyqësore (Avokati i Popullit, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Përfaqësuesi për përcaktimin e trajtimit të pabarabartë të femrave dhe meshkujve, Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit, Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Gjykata Administrative dhe gjykatat themelore), fushëveprimi i tyre, procedura, llojet e padive për mbrojtjen nga diskriminimi, dispozitat penale dhe për kundërvajtje për mbrojtje juridike nga diskriminimi dhe shkalla e suksesit me të cilin përballet sistemi nacional në lidhje me sigurimin e respektimit të lirive dhe të drejtave themelore. Autorët sugjerojnë nevojën e zhvillimit të përmbajtjeve operative standarde për trajtimin e njerëzve që janë diskriminuar, ose të cilët në cilëndo qoftë formë më të lehtë dhe/ose më të rëndë, të tërthortë dhe/ose të drejtpërdrejtë, kanë qenë palë e prekur. Autorët, të vetëdijshëm për vështirësitë e gjetjes së mjeteve, të pranueshme për të gjitha palët e prekura, bëjnë përpjekje të gjejnë zgjidhje përmes promovimit të institucioneve shtetërore, veçanërisht të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe të mënyrave të vetëmbrojtjes.

Në pjesën e tretë dhe të fundit, autorët e vënë në pah rolin dhe rëndësinë e Konventës së ratifikuar Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe zbatimin e saj si pjesë përbërëse të sistemit juridik maqedonas. Përmes pasqyrës dhe analizës komparative të rasteve nga praktika, ata e kanë përcaktuar përkushtimin e institucioneve tona gjatë krahasimit me institucionet ndërkombëtare, përkatësisht me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Autorët përkujtojnë hyrjen në fuqi të Protokollit 11, me të cilin u inkorporuan ndryshime radikale në sistemin e monitorimit dhe kishin ndikim të konsiderueshëm mbi reformat e rëndësishme procedurale të Gjykatës në Strasburg, pastaj Protokollit 12 dhe 14, të cilët kishin për qëllim zgjerimin e ndalimit të diskriminimit dhe përgjithësimin e tij jo vetëm sa u përket lirive dhe të drejtave themelore nga Konventa, por edhe sa u përket atyre që janë parashikuar me të drejtën vendase. Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, autorët vënë në dukje sistemin e vendosur formal të principeve dhe standardeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Maqedonisë, praktikën gjyqësore evropiane, rajonale dhe me praktikën vendase në lidhje me rastet për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe nevojën e informimit dhe edukimit të qytetarëve nga njëra anë dhe institucioneve relevante, nga ana tjetër. Përmes analizës së rasteve të veçanta nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lexuesit do të mund ta specifikojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë, përkatësisht të tërthortë, me ç'rast trajtimi i pabarabartë i personave është “në qendër të vëmendjes” – përkatësisht “efektet nga trajtimi i këtyre të cilët njerëzit në pozita të ndryshme i ndiejnë në mënyrë të ndryshme” – ashtu siç në të vërtetë e kanë theksuar edhe autorët.

Shpresoj se Manuali do të zgjojë interesim dhe do të jetë i dobishëm për publikun e gjerë, do ta begatojë informimin e qytetarëve dhe të institucioneve, do të ndihmojë në drejtim të gëzimit praktik të lirive dhe të drejtave të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare. Aq më shumë, ky Manual nuk do të jetë vetëm i karakterit informativ për lexuesit, por do të jetë edhe një udhëzues për detajet e dispozitave ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi. Ai, padyshim se do të kontribuojë edhe në avancimin e veprimit në fushën e antidiskriminimit ndërmjet të gjitha palëve të interesuara.

Njëra nga idetë kryesore të këtij Manuali është që në mënyrë të qartë dhe praktike ta gjejë vendin e vet në të gjitha aspektet e diskriminimit, duke e vënë theksin mbi konceptin dhe përmbajtjen e tij, me qëllim të fundit që, sa më shumë të jetë e mundur, të sqarohen të gjitha dilemat dhe paqartësitë si tek publiku profesional ashtu edhe tek publiku më i gjerë. Kjo që u tha më lartë është edhe një motiv më shumë për arsyeshmërinë e botimit të këtij Manuali gjyqësor për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Shpresoj që ky Manual të pranohet dhe pozicionohet mirë me shpresë për jetësimin e njësive të tjera të këtij lloji ose të ndonjë lloji të ngjashëm. Autorët arritën të hedhin dritë mbi aspekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Duke e pasur parasysh gjithë këtë që u theksua, me kënaqësi të veçantë e rekomandoj dhe përshëndes publikimin e Manualit gjyqësor për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, me shpresë se i njëjti do të ketë dimension të rëndësishëm aplikativ

Dr. Zoran Mihajloski

Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkup

dhe docent i emëruar në

Fakultetin e Shkencave Juridike

pranë Universitetit “Amerikan Koleh” - Shkup

KAPITULLI I PARË

HYRJE NË DISKRIMINIM

ANALIZË E LIGJIT PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Dushko Minovski

HYRJE

Tema e diskriminimit është lëndë relevante dhe mjaft komplekse. Fenomeni i diskriminimit shpeshherë ka përjetuar evoluim dhe studime shkencore. Mes tjerash, çështja e diskriminimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi në Maqedoni duhet të trajtohet edhe brenda kuadrit të konsolidimit dhe tranzicionit demokratik të shtetit në rrugën drejt realizimit të shtetit juridik bashkëkohor dhe demokratik. Ngritja e problemit të diskriminimit në nivel të prioritetit dhe zhvillimi i legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të standardeve të BE-së, gradualisht bëhen pjesë të zhvillimit demokratik global të Republikës së Maqedonisë. Në studime dhe hulumtime të ndryshme të realizuara nga shtetet e BE-së, ndërkaq në funksion të miratimit dhe përforcimit të legjislacionit kundër diskriminimit, diskriminimi vlerësohet si një fenomen këmbëngulës dhe kompleks shoqëror, ekzistimi i të cilit shpie në situatë në të cilën disa njerëz nuk mund t'i praktikojnë, në mënyrë të njëjtë me të tjerët, liritë dhe të drejtat themelore.

E drejta e mosdiskriminimit është njohur me instrumentet kryesore ndërkombëtare, siç janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar i KB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa e KB-së për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa e KB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr. 111. Dispozitat për mosdiskriminim që i përmban Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, në mënyrë plotësuese u përforcuan me hyrjen në fuqi të Protokollit 12 të kësaj Konvente, me të cilin garantohet e drejta e pavarur e trajtimit të barabartë.

Parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit janë thelbi i modelit social evropian. Ato janë guri themeltar i nocioneve dhe vlerave kryesore mbi të cilat mbështetet Bashkimi aktual Evropian. Në këtë periudhë të shkurtër është arritur shumë meqë vendet anëtare ranë dakord për nevojën e veprimit të bashkuar në nivel evropian, për përballjen me diskriminimin në bazë të: racës, origjinës etnike, bindjes fetare, moshës, handicapit dhe orientimit seksual. Së këtejmi, me legjislacionin evropian, në masë të konsiderueshme, u rrit niveli i mbrojtjes nga diskriminimi në BE.

Me fitimin e statusit të vendit kandidatit dhe rekomandimit për fillimin e negociatave aderuese, BE vazhdimisht e mbështet shtetin në lidhje me reformat prioritare përmes partneritetit për aderim dhe përmes raporteve të rregullta për progresin e vendit drejt BE-së.

Qeveria e R. të Maqedonisë bën përpjekje të vazhdueshme për harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së, dhe së këtejmi politika nga fusha e antidiskriminimit bën pjesë në kriteret politike të KE-së (të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, të drejtat ekonomike dhe sociale).

Pas fillimit të procesit euro-integrues, çështja e antidiskriminimit, si pjesë e përpjekjeve të R. të Maqedonisë që t'i përmbushë kriteret politike për aderim në BE, në dekadën e kaluar vendi shënoi progres të konsiderueshëm sa i përket mbrojtjes të të drejtave të minoriteteve. Veçanërisht të drejtat e përcaktuara me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit në masë të madhe e avancuan kornizën nacionale ligjvënëse dhe institucionale për mundësi të barabarta të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike, ndërsa Ligji për mundësi të barabarta ndërmjet meshkujve dhe femrave, si dhe strategjitë përkatëse e përforcuan krijimin e politikave duke e marrë në konsideratë perspektivën gjinore. Edhe pse u miratuan disa ligje të cilët në mënyrë eksplicite ose në mënyrë implicite e ndalonin diskriminimin, vendi nuk kishte një ligj të veçantë i cili ekskluzivisht do të merrej me antidiskriminimin.

ANALIZË E LIGJIT PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (LPMD) u miratua në muajin prill të vitit 2010. Me Ligjin kundër diskriminimit parashikohej dhe u themelua Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), i cili filloi me punë në muajin janar të vitit 2011. Sipas kësaj, për herë të parë në R. e Maqedonisë u vendos sistemi formal me principe dhe standarde që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi. Pozicioni fillestar gjatë diskutimit për atë – se çfarë organi për mbrojtjen nga diskriminimi i nevojitet R. të Maqedonisë, u determinua nga fakti se në vend ka pak përvojë dhe njohuri në fushën e diskriminimit (si nga aspekti i informimit të qytetarëve, ashtu edhe nga aspekti i zgjidhjeve ligjore dhe mbrojtjes përkatëse) dhe se KMD do të ketë një funksion jashtëzakonisht të rëndësishëm nga aspekti i promovimit të përgjithshëm të informatave në lidhje me diskriminimin dhe edukimin e qytetarëve, por edhe të institucioneve dhe strukturave të cilat duhet të marrin pjesë në implementimin e LPMD.

Diskriminimi sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Ligji e përkufizon diskriminimin si çdo bërje të dallimit të paarsyeshëm ligjor ose faktik, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose si veprim të pabarabartë, përkatësisht mosveprim (përrjashtim, kufizim ose dhënie përparësi) sa i përket personit ose grupit të personave, që mbështetet mbi gjininë, racën, ngjyrën e lëkurës, seksin, mbi përkatësinë në grupin e marginalizuar, mbi përkatësinë etnike, mbi gjuhën, mbi shtetësinë, mbi origjinën sociale, mbi religjionin ose besimin fetar, mbi arsimin, mbi përkatësinë politike, mbi statusin personal ose shoqëror, mbi pengesat mendore dhe trupore, mbi moshën, mbi gjendjen familjare ose bashkëshortore, mbi statusin pronësor, mbi gjendjen shëndetësore ose mbi çdo bazë tjetër, e cila është parashikuar me ligj ose me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare. Në këtë përkufizim në mënyrë taksative shihen bazat e numëruara të diskriminimit të cilat si të këtuja janë theksuar edhe në nenin 3 të Ligjit të njëjtë.

Sjellja dhe trajtimi diskriminues, gjithashtu, është çdo sjellje aktive ose pasive ndaj çdo personi nga ana e pushtetit, si dhe nga ana e personave fizikë dhe juridikë të sektorit privat dhe publik në jetën publike, që krijon baza për privilegjimin ose mosprivilegjimin e ndonjë personi në mënyrë të paarsyeshme, ose kur e ekspozon në sjellje të padrejtë degraduese në krahasim me persona të tjerë në situatë të ngjashme, që mbështetet mbi çdo bazë diskriminuese¹.

Ky Ligj zbatohet nga ana e të gjitha organeve shtetërore, nga organet e njësisve të vetëqeverisjes lokale, nga personat juridikë me autorizime publike, si dhe nga personat fizikë dhe juridikë (përkatësisht, e tërë shoqëria maqedonase) në fushën e:

- punës dhe marrëdhënieve të punës,
- arsimit, shkencës dhe sportit,
- sigurisë sociale, përfshirë edhe fushën e mbrojtjes sociale, sigurimit pensional dhe invalidor, sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore,
- jurisprudencës dhe administratës,
- banimit,
- informimit publik dhe mediave,
- qasjes në prona dhe shërbime,
- anëtarësimit dhe veprimit në organizata sindikale, në parti politike, në shoqata të qytetarëve dhe fondacione ose në organizata të tjera që mbështeten në anëtarësi,
- kulturës, dhe
- fushave të tjera të përcaktuara me ligj².

Format e diskriminimit

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i përkufizon format e ndryshme të diskriminimit. Kështu, **diskriminimi i drejtpërdrejtë në bazë diskriminuese** është çdo trajtim, dallim, përjashtim ose kufizim i pafavorshëm, i cili për pasojë ka ose mund të ketë heqjen, çrregullimin ose kufizimin e njohjes së barabartë, ose gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, krahasuar me trajtimin të cilin e ka, ose do të mund ta kishte personi tjetër në kushte të njëjta ose të ngjashme³.

Diskriminimi i tërthortë në bazë diskriminuese është çdo vendosje të ndonjë personi ose grupit të personave në pozitë të pafavorshme në krahasim me persona të tjerë, me miratimin e dispozitave evidente neutrale, kritereve ose me ndërmarrjen e praktikave të caktuara, përveç kur dispozitat, kriteret ose praktikat e këtilla burojnë nga një qëllim i justifikueshëm, ndërkaq mjetet për arritjen e këtij qëllimi janë adekuate dhe të domosdoshme⁴.

¹ Neni 5, pika 4 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

² Neni 4 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

³ Neni 6, paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

⁴ Neni 6, paragrafi 2 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Shqetësimi dhe trajtimi përçmues, në këtë Ligj, është përkufizuar si cenim i dinjitetit të personit ose të grupit të personave, i cili rezulton nga baza diskriminuese dhe ka për qëllim ose dëshiron të arrijë cenimin e dinjitetit të një personi të caktuar ose krijimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, përçmues ose frikësues, qasjes ose praktikës. Rrjedhimisht me këtë, **shqetësimi seksual** përkufizohet si sjellje e padëshiruar e karakterit gjinor, e cila shprehet fizikisht, verbalisht ose në çdo mënyrë tjetër, ndërkaq ka për qëllim ose për pasojë cenimin e dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet mjedis armiqësor, kërcënues, degradues ose përçmues⁵.

Ligji, duke e detektuar domosdoshmërinë e përkufizimit më të përafërt të diskriminimit në bazë të pengesave mendore dhe trupore, përmban dispozitë në të cilën me **diskriminim të personave me pengesa mendore dhe trupore** nënkuptohet pamundësimi i qëllimshëm ose qasje e vështirësuar deri në mbrojtjen shëndetësore, përkatësisht shkurtimi i të drejtave të mbrojtjes shëndetësore të trajtimit të rregullt mjekësor dhe ilaçeve, të mjeteve për rehabilitim dhe masave në përputhje me nevojat e tyre, shkurtimi i të drejtës së martesës dhe krijimit të familjes, si dhe të drejtave të tjera nga fusha e martesës dhe marrëdhënieve familjare, shkurtimi i të drejtës së arsimit, punës dhe të drejtave nga marrëdhënia e punës. Diskriminimi i personave me pengesa mendore dhe trupore ekziston edhe atëherë kur nuk do të ndërmerren masa për shmangien e kufizimeve, përkatësisht përshtatjen e infrastrukturës dhe hapësirës, shfrytëzimin e resurseve publikisht të arritshme, ose pjesëmarrjen në jetën publike dhe shoqërore⁶. Në kontekst të personave me pengesa, në Ligj theksohet edhe rëndësia e nocionit **përshtatje të infrastrukturës dhe të shërbimeve**, si marrje të masave përkatëse, të nevojshme në raste të caktuara, që t'i mundësohet personit me pengesa mendore dhe trupore të ketë qasje, të merr pjesë dhe të avancohet në procesin e punës, përveç nëse këto masa nuk imponojnë ngarkesa disproporcionale për punëdhënësit⁷.

Së këtejmi, si forma të diskriminimit, në Ligj theksohen edhe **thirrja dhe nxitja e diskriminimit**⁸, **diskriminimi gjatë sigurimit të pronave dhe shërbimeve**⁹, përkufizohet edhe **viktimizimi**¹⁰ dhe numërohen format më të rënda të diskriminimit (diskriminim i shumëfishtë, diskriminim i përsëritur, diskriminim i vazhdueshëm dhe diskriminim i cili me pasojat e veta jashtëzakonisht rëndë e godet personin e diskriminuar)¹¹.

⁵ Neni 7 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

⁶ Neni 8 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

⁷ Neni 5, pika 12 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

⁸ Neni 9 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

⁹ Neni 11 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹⁰ Neni 10 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹¹ Neni 12 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Përrjashtime nga diskriminimi

Ligji parashikon tre lloje të përrjashtimeve nga diskriminimi: **masa afirmative** (në kontekst të arritjes së barazisë së plotë faktike të personit, të grupit të personave ose të komunitetit, si dhe në kontekst të mbrojtjes së grupeve të margjinalizuara)¹², **trajtimi i pabarabartë** (ku theksohen të gjitha llojet e lejuara të trajtimit të pabarabartë që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetësisë, marrëdhëniet e punës, religjionin dhe besimin fetar, gjininë, arsimin, marrëdhëniet martesore, lirinë e fjalës dhe moshën)¹³ dhe **mekanizma mbrojtës për kategori të caktuara të personave** (që kanë të bëjnë me gruan shtatzënë dhe nënën, personat me handicap, fëmijët pa prindër, me të miturit dhe prindërit e vetëm, moshën minimale dhe maksimale në kontekst të arsimit, masat për stimulimin e punësimit, masat për sigurimin e balancimit gjinor etj.)¹⁴.

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Nga themelimi i Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i njëjti u imponua si autoritet nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, duke e përfshirë edhe zhvillimin, promovimin dhe afirmimin e principeve të barazisë të të drejtave të njeriut dhe tolerancës. Në këtë kontekst synimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit është që të përforcohet pozita e tij dhe të kontribuohet në drejtim të identifikimit të tij si promotor në luftën kundër diskriminimit, si nga ana e institucioneve ashtu edhe nga ana e qytetarëve.

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi u themelua me **Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi** i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më datë 8 prill të vitit 2010¹⁵.

Në përputhje me këtë Ligj, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi është themeluar si **autoritet nacional qendror** për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe për afirmimin dhe promovimin e barazisë, mosdiskriminimit dhe tolerancës. Praktikisht, kompetencat e Komisionit në bazë mund të ndahen në **dy shtylla fundamentale** – mbrojtje nga diskriminimi (**funksion mbrojtës i Komisionit**) dhe promovimi i barazisë dhe mosdiskriminimit (**funksion promovues i Komisionit**). Më konkretisht, Ligji i përcakton këto kompetenca të Komisionit :

- **vepron sipas parashtrësve**, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit;
- parashtruesit të parashtrësës **i jep informata për të drejtat e tij** dhe mundësi për ngritjen e procedurës gjyqësore ose të procedurës tjetër për mbrojtje;
- **ngre iniciativë** për hapjen e procedurës para organeve kompetente për shkak të shkeljeve të bëra ndaj këtij Ligji;

¹² Neni 13 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹³ Neni 14 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹⁴ Neni 15 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 50/2010 nga data 13.04.2010.

- **paraqet raport vjetor** në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë;
- **e informon publikun** për rastet e diskriminimit dhe ndërmerr aktivitete për edukimin dhe promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit;
- **e monitoron zbatimin e këtij Ligji**, inicion ndryshime të akteve normative me qëllim të implementimit dhe avancimit të mbrojtjes nga diskriminimi;
- **vendos bashkëpunim** me organet kompetente për zbatimin e barazisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në pushtetin lokal;
- **u jep rekomandime organeve shtetërore** për ndërmarrjen e masave për realizimin e barazisë;
- **jep mendime për propozim-ligje** të rëndësishëm për mbrojtjen nga diskriminimi;
- **grumbullon të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera**, formon baza të të dhënave, realizon studime, hulumtime dhe trajnime në lidhje me diskriminimin;
- **bashkëpunon** me organe përkatëse nacionale të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi;
- **miraton Rregullore pune** dhe akte të tjera për organizimin e brendshëm të punës¹⁶.

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi me punë më 1 janar të vitit 2011, si **organ i pavarur dhe autonom**¹⁷. Komisioni ka status të personit juridik dhe është vendosur në objektin e Radiotelevizionit të Maqedonisë, në rrugën “Kej Dimitar Vllahov” p.n., kati 20, Shkup¹⁸. Mjetet për punën e Komisionit sigurohen nga **Buxheti i Republikës së Maqedonisë**, ndërsa mjete financiare mund të sigurohen edhe nga burime të tjera¹⁹.

Komisioni përbëhet nga **7 anëtarë**²⁰, të cilët i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Anëtarët kanë mandat **5 vjeçar**, me të drejtë **edhe për një rizgjedhje**²¹. Anëtarët e Komisionit kanë status **të personave të emëruar**²², që nënkupton se ky funksion ushtrohet paralelisht me angazhim profesional të punës jashtë Komisionit.

¹⁶ Neni 24 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹⁷ Neni 16, paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹⁸ Neni 16, paragrafi 2 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

¹⁹ Neni 16, paragrafi 3 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

²⁰ Neni 17, paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

²¹ Neni 17, paragrafi 2 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

²² Neni 21, paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

KAPITULLI I DYTË

MEKANIZMAT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI ORGANET PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

- MBROJTJA JASHTË-GJYQËSORE
- MBROJTJA GJYQËSOREA

Lençe Kocevaska

MEKANIZMAT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Diskriminimi në masë më të madhe ose më të vogël është i pranishëm në të gjitha shtetet. Komponent i rëndësishëm në luftën kundër diskriminimit është miratimi i legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe njëkohësisht, krijimi i mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi të cilët do të sigurojnë zbatimin e këtij legjislacioni.

Me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi, çdo shtet ka detyrim dhe përgjegjësi të krijojë kushte për mbrojtjen e të gjithë atyre të cilët janë viktime ose mund të bëhen viktime të aktiviteteve diskriminuese.

Organet për barazi në të gjitha shtetet janë jashtëzakonisht të rëndësishme për implementimin e legjislacionit kundër diskriminimit, me rolin e tyre që duhet ta kenë në drejtim të mbështetjes së viktimave të diskriminimit, përmes dhënies së udhëzimeve dhe rekomandimeve subjekteve publike dhe private, si dhe pjesëmarrësve të tjerë dhe publikut në lidhje me të drejtat e mosdiskriminimit, arritjes së barazisë, rritjes së ndërgjegjësimit për konceptin e mosdiskriminimit, përmes realizimit të sondazheve dhe hulumtimeve që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe mënyrat se si mund të reduktohet ai.

Për ta ushtruar funksionin e tyre dhe për t'u paraqitur si faktor konstruktiv në luftën kundër diskriminimit, organet për barazi duhet të plotësojnë minimum standarde të caktuara. Organet për barazi duhet të përkufizohen me ligj ose me akt normativ, të jenë të pavarur në veprimin e tyre, të kenë mandat të gjerë që nënkupton procedim sipas ankesave individuale, si dhe funksion këshillëdhënës, konsulent dhe edukativ.

Në përputhje me legjislacionin nacional, në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë më shumë institucione dhe organe të cilat mund të jenë jashtë-gjyqësore, të njohura si organe për barazi dhe organe gjyqësore në të cilat mbrojtje mund të kërkojnë të gjithë personat fizikë dhe juridikë të cilët janë diskriminuar dhe gjenden në pozitë të pabarabartë.

Organe jashtë-gjyqësore të cilat ofrojnë mbrojtje nga diskriminimi në Republikën e Maqedonisë janë:

1. Avokati i Popullit
2. Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
3. Përfaqësuesi për përcaktimin e trajtimit të pabarabartë të femrave dhe meshkujve
4. Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit
5. Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive.

Mbrojtja gjyqësore nga diskriminimi realizohet përpara:

1. Gjykatës Kushtetuese të RM-së
2. Gjykatës Administrative të RM-së
3. Gjykatave themelore të RM-së

ORGANET PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI MBROJTJA JASHTË-GJYQËSORE

Avokati i Popullit i RM-së është institucion i pavarur dhe autonom në ushtrimin e funksionit. Ai është organ i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve dhe të të gjithë personave të tjerë kur u cenohen të drejtat me akte, veprime dhe me mosveprime nga ana e organeve të administratës shtetërore, nga organet dhe organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike, si dhe ndërmerr masa për mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, në organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe në institucionet dhe shërbimet publike.

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi është organ i pavarur dhe autonom i cili ka cilësinë e personit juridik, me seli në Shkup.

Komisioni ka kompetenca të gjera në domenin e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi, afirmimit dhe avancimit të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Përfaqësuesi për përcaktimin e trajtimit të pabarabartë të femrave dhe meshkujve është person i punësuar si nëpunës shtetëror në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, i ngarkuar të zhvillojë procedurë për përcaktimin e trajtimit të pabarabartë të femrave dhe meshkujve.

Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë shqyrton çështje parimore, jep propozime dhe mendime në lidhje me gjendjen për avancimin e më tutjeshëm të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve dhe këtij Komisioni mund t'i drejtohen edhe qytetarët.

Komiteti për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, si trup i përhershëm punues i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, shqyrton çështje nga fusha e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive dhe jep mendime dhe propozime për zgjidhjen e tyre.

KOMPETENCAT (NGJASHMËRI DHE DALLIME)

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë e ka rolin e mekanizmit parandalues nacional dhe vepron sipas parashtresave individuale të parashtuara nga persona fizikë dhe juridikë, vepron edhe me iniciativë të vet në rastet e cenimit të të drejtave kushtetuese dhe ligjore nga ana e organeve të administratës shtetërore, organeve dhe organizatave të tjera të cilat kanë autorizime publike.

Nëse pas zbatimit të procedurës konstatohet cenim, Avokati i Popullit mund të jep rekomandime, sugjerime, mendime dhe propozime për mënyrën e shmangies së atyre cenimeve, të propozojë sërish të zhvillohet një procedurë e caktuar dhe të ngre iniciativë për hapjen e procedurës disiplinore ose ndonjë procedure tjetër për përgjegjësi.

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimin vepron sipas parashtresës së parashtruar nga të gjithë **personat fizikë dhe juridikë të sektorit privat dhe shtetëror** kur ndonjë person është diskriminuar në cilëndo qoftë bazë, që është përcaktuar në nenin 3 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Për diskriminimin e konstatuar, Komisioni aprovon mendim, me të cilin rekomandon mënyrën e shmangies së cenimeve të së drejtës. Komisioni mund të ngre iniciativë për hapjen e procedurës përpara organit kompetent për përcaktimin e përgjegjesisë.

Përfaqësuesi për përcaktimin e trajtimit të pabarabartë të femrave dhe meshkujve vepron sipas parashtresës së parashtruar nga personi fizik, nga shoqata të qytetarëve, nga sindikata dhe nga persona të tjerë juridikë, nga sektori publik dhe privat, si dhe me iniciativë të vet kur ndonjë person **është diskriminuar në bazë të gjinisë**.

Përfaqësuesi për rastin përpilon mendim në kontekst të asaj se a ekziston trajtim i pabarabartë ose jo. Në mendimin me shkrim mund të ceken edhe parregullsitë të cilat janë konstatuar në rastin konkret, si dhe të jepen rekomandime si të shmangen të njëjtat, ndërkaq nga pala e cila i ka bërë këto parregullsi mund të kërkohet të ndërmerret masa për shmangien e këtyre parregullsive dhe ta njoftojë Përfaqësuesin për atë se cilat masa i ka ndërmarrë. Rekomandimet nuk janë të karakterit detyrues-juridik për kryerësin e cenimit-diskriminimit.

1. Parashtruesi i parashtresës lirohet nga pagesa e taksave ose të kompensimit tjetër për parashtresën e parashtruar përpara Avokatit të Popullit, përpara Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe para Përfaqësuesit.
2. Parashtresa duhet të nënshkruhet, të përmbajë të dhëna personale të parashtruesit dhe t'i përmbajë rrethanat, faktet dhe provat mbi të cilat bazohet parashtresa.
Në parashtresë duhet të theksohet organi, organizata, institucioni dhe personi me të cilin ka të bëjë parashtresa, si dhe të theksohet nëse parashtruesi paraprakisht i është drejtuar ndonjë organi.
3. Procedura e hapur sipas parashtresës përfundon në afat prej 90 ditësh nga dita e parashtrimit (KMD dhe Përfaqësuesi).
4. Aprovohet mendim, jepet rekomandim dhe sugjerim për mënyrën e shmangies së cenimeve të konstatuara.

Shtrohet pyetja: a ka kompetencë primare ndonjëri nga këto organe, ndërsa të tjerët sekondare dhe a ekziston një radhitje e përcaktuar gjatë veprimit? Kjo i lihet në dispozicion personit i cili mendon se është viktimë e trajtimit të pabarabartë dhe të diskriminimit në cilëndo qoftë bazë, në mënyrë të pavarur të vendos cilit prej organeve dhe institucioneve do t'u drejtohet apo në mënyrë të drejtpërdrejtë do të kërkojë mbrojtje gjyqësore para gjykatave të rregullta, ose para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë. Gjendja e këtillë

e pluralizmit dhe komplementaritetit të kompetencave është e njohur dhe e pranishme edhe në shumë vende evropiane dhe kjo konsiderohet si pasojë normale e zhvillimit dinamikë dhe tendencë e vazhdueshme e begatimit dhe zgjerimit të mekanizmave për mbrojtje dhe luftë efikase kundër diskriminimit dhe për respektimin e të drejtave të njeriut. Gjendja e këtyllë nuk duhet të konsiderohet si konflikt të kompetencave por, përkundrazi kjo gjendje duhet të konsiderohet si përparësi dhe të zgjidhet përmes konsultimeve të ndërsjella dhe dialogut ndërmjet organeve/institucioneve të interesuara dhe kjo të jetë në interesin më të mirë të qytetarëve dhe barazisë së tyre.

PROCEDURA PARA KOMISIONIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Procedura para Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi hapet me parashtrimin e parashtrësës me shkrim ose me gojë, në procesverbal, pa obligim për pagesë të taksës ose kompensimit tjetër. Parashtrësë mund të parashtrrojë çdo person (fizik ose juridik), i cili konsideron se ka pësuar diskriminim, me këtë rast pa u ekspozuar në shpenzime. Personi, parashtrësës ia bashkëngjijt faktet dhe provat prej të cilave mund të presupozohet se ka pasur diskriminim.

Afati i parashtrimit të parashtrësës është tre muaj nga dita kur është bërë cenimi, ose më së voni një vit nga marrja e dëgjimit për aktin e diskriminimit. Nëse Komisioni vlerëson se bëhet fjalë për rast me peshë të tillë për shkak të të cilit domosdoshmërisht duhet të zhvillohet procedurë, mund të hapet procedurë edhe pas skadimit të afatit.

Shembull: Nëse mos hapja e procedurës do të shkaktonte pasoja të rënda mbi jetën dhe mbi shëndetin e parashtruesit të parashtrësës, ose dëm të konsiderueshëm material.

Një element tjetër, mjaft i rëndësishëm, është përdorimi i gjuhës gjatë procedurës. Procedura zhvillohet në gjuhën maqedonase, ndërsa personat të cilët jetojnë në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat ka më së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, mund ta përdorin gjuhën tjetër zyrtare dhe alfabetin e saj.

Komisioni nuk do të hap procedurë sipas parashtrësës të parashtruar nëse konstaton se:

- sa i përket parashtrësës së parashtruar tanimë është hapur dhe ka përfunduar në mënyrë të plotfuqishme procedura gjyqësore;
- nëse nuk konstatohet ekzistim i cenimit të cilit i referohet parashtruesi;
- nëse tanimë është proceduar për çështjen e njëjtë dhe nuk propozohen prova të reja;
- kur nga cenimi i bërë ka kaluar një kohë më e gjatë dhe nuk mund të arrihet qëllimi i procedurës;

Përcaktimi i gjendjes faktike

Kur Komisioni do të vendos të veprojë sipas parashtresës së parashtruar, në afat prej 15 ditësh nga pranimi, parashtresën ia dërgon personit kundër të cilit është parashtruar. Personi, kundër të cilit është parashtruar parashtresa, mund të deklarohet për të dhënat e prezantuara në parashtresë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i saj. Nëse personi të cilit i është dërguar parashtresa nuk deklarohet për të dhënat e prezantuara në parashtresë, Komisioni do të vendos në bazë të provave të cilat i ka në dispozicion. Komisioni e përcakton gjendjen faktike nga këqyrja në provat e dorëzuara me shkrim, me marrjen e deklaratës nga parashtruesi i parashtresës dhe me deklaratë nga personi kundër të cilit është parashtruar parashtresa. Nëse Komisioni konstaton se provat që i ka në dispozicion nuk mjaftojnë për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, mund të merr deklarata dhe të sigurojë prova nga subjekte të tjera të cilat posedojnë të dhëna për rastin konkret të diskriminimit.

Mendime dhe rekomandime

Pas përcaktimit të gjendjes faktike, Komisioni aprovon mendim për diskriminimin e supozuar, i cili nuk ka efekt detyrues-juridik. Mendimi duhet të përmbajë arsyetim me shkrim, cilat veprime janë ndërmarrë dhe cilat prova i ka prezantuar Komisioni, cilave prova u ka besuar dhe cilat prova nuk i ka marrë parasysh gjatë vendimmarrjes dhe në bazë të cilave fakte dhe prova e mbështet mendimin e vet dhe e konstaton diskriminimin. Mendimin e aprovon në afat prej 90 ditësh nga dita e parashtrimit të parashtresës dhe për këtë e njofton parashtruesin e parashtresës dhe personin kundër të cilit është parashtruar parashtresa. Nëse Komisioni konstaton diskriminim, në mendimin me shkrim rekomandon mënyrën e shmangies së cenimit të së drejtës. Personi, të cilit Komisioni ia ka dërguar rekomandimin, obligohet që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të rekomandimit, ta shmangë cenimin e të drejtës dhe për këtë ta njoftojë Komisionin. Kur personi, të cilit i është dërguar rekomandimi, nuk vepron në afat prej 30 ditësh sipas rekomandimit dhe nuk do ta shmangë cenimin e së drejtës, Komisioni ka autorizime të ngre iniciativë për hapjen e procedurës para gjykatës kompetente për përcaktimin e përgjegjësisë së tij.

Shembull (Komisioni mund të hap procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë për kundërvajtje ose penale).

Bashkëpunimi me organet e tjera

Nëse Komisioni ka informata se për parashtresën e paraqitur për diskriminim ndonjë person fizik ose juridik, organ shtetëror, organ i njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe organe e organizata të tjera, të cilat ushtrojnë autorizime publike dhe institucione e shërbime publike, kanë në dispozicion të dhëna për rastin konkret të diskriminimit, me kërkesë të Komisionit ata e kanë për detyrë t'i dërgojnë ato të dhëna.

Nga kjo rezulton obligimi për bashkëpunimin e organeve të tjera me Komisionin kur ai vepron për raste konkrete të diskriminimit.

Në rastin kur do të konstatojë se është e nevojshme, Komisioni mund të bëjë këqyrje në dokumentacionin e organeve paraprakisht të përmendura, të cilat kanë në dispozicion të dhëna dhe informata konkrete për rastet e diskriminimit.

Për raste konkrete të diskriminimit, Komisioni bashkëpunon me Avokatin e Popullit. Duke i marrë parasysh kompetencat e Avokatit të Popullit, si organ i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur ato u cenohen me akte dhe veprime të organeve të administratës shtetërore dhe të organeve e organizatave të tjera të cilat kanë autorizime publike dhe si organ i cili ndërmerr veprime dhe masa për mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit, bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy organeve është i domosdoshëm.

MBROJTJA GJYQËSORE GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Kushtetuta parashikon mekanizëm mbrojtës nga çdo formë e diskriminimit që bazohet mbi përkatësinë gjinore, racore, fetare, kombëtare, sociale dhe politike, përmes paraqitjes së iniciativës/kërkesës përpara Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen nga diskriminimi.

Me iniciativën mund të pohohet se një vendim i caktuar ose praktikë/gjendje e shkel principin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Praktika e Gjykatës Kushtetuese vë në pah se deri më tani qytetarët kanë paraqitur një numër të vogël kërkesash për mbrojtjen nga diskriminimi sipas së cilave Gjykata më së shpeshti është shpallur për jokompetente dhe nuk ka marrë vendime meritore.

GJYKATA ADMINISTRATIVE

Mbrojtja administrative gjyqësore përfshin mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve nga cenimet e bëra me akte të veçanta të paligjshme të administratës shtetërore dhe të organeve e organizatave të tjera të cilat kanë autorizime publike.

GJYKATAT THEMELORE MBROJTJA JURIDIKE-CIVILE

Çfarë mbrojtje juridike civile nga diskriminimi i palejuar është vënë në dispozicion të personave të diskriminuar, ku duhet të drejtohen qytetarët dhe çfarë lloje të padive janë parashikuar, është dhënë në kapitullin në vijim.

Personi, i cili konsideron se i është cenuar ndonjë e drejtë ka mundësi të iniciojë procedurë gjyqësore me paraqitjen e padisë përpara gjykatës kompetente.

Njëra nga kompetencat e Komisionit është që parashtruesit të parashtrësës t'i jepen informata për të drejtat dhe mundësitë e tij për ngritjen e procedurës gjyqësore, ose ndonjë procedure tjetër për mbrojtje.

Në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi parashikohet procedurë e veçantë gjyqësore civile për rastet e cenimit të së drejtës së trajtimit të barabartë, sipas një ose sipas më shumë bazave diskriminuese. Procedura iniciohet me padi përpara gjykatës kompetente dhe ajo ka karakter të procedurës urgjente, ndërkaq zhvillohet në përputhje me dispozitat e ligjit për procedurë kontestimore. Kjo do të thotë se, gjykata, pas paraqitjes së padisë, në afat më të shkurtër të mundshëm, duhet të veprjë sipas të njëjtës (nuk ka afate eksplicite), megjithatë shpejtësia e vendimmarrjes, sipas padisë së paraqitur, do të varet nga rasti në rast dhe varësisht nga kompleksiteti i lëndës, por gjithsesi e tërë procedura duhet të përfundojë brenda afatit të arsyeshëm.

Llojet e padive për mbrojtjen nga diskriminimi

Me padinë për mbrojtjen nga diskriminimi personi – paditësi mund të kërkojë:

1. Gjykata të konstatojë se i padituri e ka cenuar të drejtën e trajtimit të barabartë të paditësit, përkatësisht veprimin që e ka ndërmarrë, ose mosveprimi mund shpie deri në cenimin e të drejtës së trajtimit të barabartë.

Me këtë lloj padie, gjykata vetëm konstaton se është bërë diskriminim, se ndonjë person është vënë në gjendje më të pavolitshme në krahasim me një tjetër dhe në këtë rast gjykata miraton aktgjykim deklarativ ose vërtetues me të cilin konstatohet ekzistimi i diskriminimit.

Me kërkesëpadinë paditësi kërkon të përcaktohet se veprimi i caktuar i të paditurit paraqet akt diskriminimi.

2. Gjykata të ndalojë ndërmarrjen e veprimeve me të cilët cenohet ose mund të cenohet e drejta e trajtimit të barabartë e paditësit, përkatësisht të kryhen veprime me të cilët shmanget diskriminimi ose pasojat e tij – aktgjykim dënues.

Kërkesëpadia e kësaj padie është si vijon:

- diskriminuesi të përmbahet nga ndërmarrja e veprimit të caktuar, të cilin akoma nuk ka filluar ta bëjë, përkatësisht gjykata t'ia ndalojë ndërmarrjen e një veprimi të caktuar të cilin nuk ka filluar ta kryejë, nëse qëllimi i një veprimi të tillë paraqet akt diskriminues, përkatësisht cenim i ndonjë të drejte.

Shembuj për këtë lloj kërkesëpadie janë:

- paditësi të kërkojë të mos vendoset mbishkrimi i paralajmëruar, me të cilin diskriminohen njerëzit për shkak të ndonjë veçorie të tyre personale;
- diskriminuesi të përmbahet nga kryerja e ndonjë veprimi, përkatësisht gjykata t'ia ndalojë kryerjen e ndonjë veprimi, i cili paraqet akt diskriminues;

- të mos vazhdojë me shqetësimin e ndonjë personi për shkak të ndonjë veçorie të tij personale, kur një shqetësim i tillë është në rrjedhë;
- diskriminuesi të përmbahet nga përsëritja e ndonjë veprimi të caktuar, përkatësisht gjykata t'ia ndalojë përsëritjen e veprimit diskriminues;
- t'i ndalohet që në të ardhmen të vazhdojë të refuzojë t'i ofrojë shërbim dikujt për shkak të ndonjë veçorie të tij personale;
- të kërkojë nga diskriminuesi të kryej një veprim të caktuar, përkatësisht gjykata t'i urdhërojë diskriminuesit të kryejë ndonjë veprim të caktuar me të cilin do t'i shmangë pasojat e shkaktuara me aktin diskriminues;
- ta heq mbishkrimin me të cilin ndalohet qasja e personave me veçori të caktuara personale, t'i heq bilbordet me përmbajtje diskriminuese, t'i shmangë pengesat arkitektonike me të cilat pamundësohet qasja e personave me invaliditet, në shpalljen e publikuar t'i heq kushtet të cilat paraqesin diskriminim.

3. Të kërkohet kompensim i dëmit material dhe jomaterial i shkaktuar me cenimin e të drejtave.

Në këtë rast, gjykata vendos për bazën dhe lartësinë e kërkesës për dëmshpërblim, në përputhje me Ligjin për marrëdhënie detyrimore.

Shembull për dëm jomaterial:

- Paditësi, si rezultat i një veprimi të caktuar nga ana e të paditurit, ka pësuar pasoja të rënda mbi jetën dhe mbi shëndetin dhe i është çrregulluar gjendja shëndetësore, prandaj në rast të kësaj paditësi mund të kërkojë dëmshpërblim jomaterial, i cili ka të bëjë me shkaktimin e dhimbjes psikike, përjetimin e frikës, çrregullimin e gjendjes shëndetësore etj.

Intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjes psikike do të përcaktohet me ekspertizë mjeko-ligjore.

Shembull për dëm material

- Paditësi ka pësuar ndonjë dëm material i cili ka të bëjë me përfitimin e humbur për shkak të mungesës nga puna, ka qenë i ekspozuar në shpenzime për mjekim, nevojës për ilaçe etj.
- Paditësi ka qenë i detyruar ta ri bojatisë fasadën e objektit të tij me qëllim që t'i mbulojë grafitet me përmbajtje ofenduese.

4. Të kërkojë në media të publikohet tërësisht ose pjesërisht aktgjykimi me të cilin është përcaktuar cenimi i të drejtës së trajtimit të barabartë edhe atë me shpenzime të të paditurit, nëse cenimi është bërë me ndërmjetësimin e mediave ose nëse është e nevojshme, aktgjykimi të publikohet për shkak të parandalimit-të përgjithshëm ose të veçantë.

Të gjitha këto kërkesa, pranë gjykatës mund të paraqiten veç e veç ose bashkë me kërkesat për mbrojtjen e të drejtave të tjera, për të cilat vendoset në procedurë kontestimore.

Masa e sigurisë

Para fillimit të procedurës gjyqësore, ose gjatë vetë procedurës, personi, e drejta e të cilit është cenuar-paditësi, pranë gjykatës kompetente mund të jep propozim për përcaktimin e masës së sigurisë. Gjykata mund të miratojë masë të përkohshme, me të cilën të paditurit do t'ia ndalojë që edhe më tutje të ndërmerri veprime. Masa e përkohshme vlen deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Në mënyrë që të merret në konsideratë masa e përkohshme, paditësi duhet ta bëjë të besueshme kërkesën e tij, përkatësisht duhet ta bind gjykatën se ajo është e bazuar dhe se pa masën e përkohshme ekziston rreziku që paditësi nuk do të mund ta realizojë kërkesën e vet, ose realizimi i saj do të vështirësohet. Përkatësisht, do të pësonte dëm të pakompensueshëm.

Barra e provës

Kjo dispozitë është me rëndësi të jashtëzakonshme për t'u siguruar ndihmë dhe mbrojtje personave të diskriminuar dhe për stimulimin e denoncimit të rasteve të diskriminimit, por njëkohësisht edhe dispozitë me të cilën viktimat e diskriminimit dhe të gjithë ata që denoncojnë diskriminim ose paraqiten si dëshmitarë në procedurat gjyqësore, duhet të mbrohen nga viktimizimi. Sipas principit të bartjes së barrës së provës, viktimat e diskriminimit e kanë për detyrë të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim. Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, përkatësisht se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë. Edhe në Ligjin për marrëdhënie pune dhe në Ligjin për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve, Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, barra e provës bie mbi të paditurin, përkatësisht ai dëshmon se nuk ka pasur diskriminim. Ndërkaq, obligim i paditësit është që me prezantimin e të gjitha fakteve dhe provave, të cilat e arsyetojnë, ta bëjë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Përjashtim nga ky rregull për barrën e provës janë procedurat penale dhe për kundërvajtje, ku parimi i prezumimit të pafajësisë vihet në plan të parë, përkatësisht ai i cili pohon se pala e kundërt ka kryer ndonjë shkelje, këtë duhet ta dëshmojë.

Rregullat e dëshmimit në procedurën për diskriminim

Ekzistojnë rregulla standarde për të ashtuquajturën barra e provës, të cilat përcaktojnë që secila palë, e cila thirret në ndonjë fakt i cili për atë është i

favorshëm, e ka për detyrë, deri në njëfarë shkalle, ta dëshmojë këtë fakt, ndërsa nëse nuk arrin sukses, gjykata nuk do ta merr në konsideratë atë fakt, prandaj mbi këtë bazë pala mund ta humb kontestin.

Në procedurën për mbrojtjen nga diskriminimi vlejné rregulla të tjera për të ashtuquajturën barrë të provës. Meqenëse është jashtëzakonisht e vështirë të dëshmohet se trajtimi i pabarabartë ndaj ndonjë personi ose grup personash bazohet mbi ndonjë veçori personale, mbi ndonjë bazë diskriminuese, duhet të inkorporohen rregulla të veçanta të cilat e lehtësojnë gjendjen e paditësit, ndërsa ato rregulla duhet të përmbajnë:

- paditësi vetëm duhet t'i bëjë të besueshme provat se është bërë diskriminim – përkatësisht se i padituri e ka vënë në pozitë të pabarabartë të pafavorshme për shkak të ndonjë veçorie të tij personale;
- nëse këtë e bën me sukses, atëherë ekziston supozimi se është shkelur parimi i barazisë;

Nga ky moment diskriminuesi i paditur e ka për detyrë të dëshmojë se nuk e ka shkelur këtë parim, ndërsa nëse këtë nuk e arrin, gjykata duhet të vendos se është shkelur parimi i barazisë dhe në këtë rast është kryer diskriminim.

Shembull:

Një grua e punësuar pohon se punëdhënësi i paguan pagë më të ulët në krahasim me kolegun e saj, i cili është mashkull, edhe pse bëjnë punën e njëjtë.

Nëse ajo dëshmon se paga e saj është më e ulët, ekziston supozimi se është kryer diskriminim në bazë të gjinisë. Këtë supozim, punëdhënësi mund ta kontestojë nëse dëshmon se punët të cilat i kanë kryer nuk janë të njëjta, ose se mashkullit të punësuar i ka paguar më tepër, por se këtë e ka bërë për shkak se i ka paguar edhe kompensim për jetë të veçantë, sepse familja e tij jeton në qytet tjetër.

Gjithashtu, duhet të merret parasysh se tek diskriminimi nuk dëshmohet qëllimi, motivi ose shkakun për të cilin dikush dikë e ka diskriminuar, por është i rëndësishëm efekti. Disa diskriminues bëjnë diskriminim për shkak të disa qëndrimeve të tyre raciste ndaj romëve, paragjykimeve që i kanë ndaj femrave, komunitetit LGBT dhe ngjashëm. Nga aspekti i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi kjo nuk është e rëndësishme sepse ligji nuk mundet tua ndalojë njerëzve qëndrimet e caktuara, por vetëm veprimet me të cilët realizohen ato qëndrime.

Pjesëmarrja e personave të tretë

Gjatë procedurës, si palë e involvuar në anën e personit i cili pohon se është diskriminuar dhe me pëlqimin e tij mund të inkuadrohet organi, organizata, institucioni, shoqata ose person tjetër i cili, në kuadër të veprimtarisë së vet merret me mbrojtjen e të drejtave të trajtimit të barabartë. I involvuari i ka të

gjitha të drejtat dhe mund të ndërmerr veprime gjatë procedurës dhe ai i bart shpenzimet për pjesëmarrjen e tij në procedurë.

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të paraqitet në rolin e të involvuarit në procedurën kontestimore, të ngritur me padi individuale ose padi të përbashkët, ose të paraqitet si dëshmitar nga ana e personit i cili është diskriminuar.

Shpallja publike e aktgjykimit

Mundësia për publikimin e aktgjykimit paraqet mënyrë të rëndësishme për rritjen e ndërgjegjësimit për atë se çka paraqet diskriminim i lejuar e çka diskriminim i palejuar, për arsye se për opinionin publik nuk është me rëndësi vetëm ajo që paditësi ka pasur sukses në kontestin, por edhe se shteti i mbron nga veprimet diskriminuese, se veprimi i tillë nuk lejohet dhe se për një veprim të këtillë janë parashikuar pasoja juridike të caktuara (sanksione). Me shpalljen publike të aktgjyqimeve ngrihet edhe niveli i sigurisë juridike tek qytetarët.

Gjykata nuk e publikon aktgjykimin sipas detyrës zyrtare, por vetëm nëse paditësi paraqet kërkesë për publikimin e tij.

Aktgjykimi publikohet me shpenzimet e të paditurit - diskriminuesit.

Në Ligj ceket se aktgjykimi publikohet vetëm nëse cenimi i të drejtës së trajtimit të barabartë është me ndërmjetësimin e mediave.

Shtrohet pyetja: a do të ketë bazë kërkesa për publikimin e aktgjykimit nëse veprimi diskriminues është bërë publikisht, domethënë jo vetëm nëse cenimi i së drejtës është bërë përmes mediave, por nëse cenimi është bërë përmes internetit, bilborderve, pamfleteve nëpër mitingje, stadione, gjatë kohës së shfaqjeve publike etj.

Praktika gjyqësore, në disa vende fqinje, tregon se kërkesa e këtillë ka bazë dhe se gjykata duhet ta shpall publikisht aktgjykimin.

Shembull: Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Shabac.

Gjykata e ka angazhuar Qendrën Rekreative-Sportive “Kërsmanoviq” të publikojë falje publike personave të diskriminuar, ndërkaq nëse nuk e bën këtë, paditësi ka autorizim që në gazetën e njëjtë të përditshmen ta publikojë aktgjykimin e shqiptuar.

Padi e përbashkët për mbrojtjen nga diskriminimi

Në procedurën gjyqësore, në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi parashikohet mundësia për paraqitjen e padisë së përbashkët.

Në këtë kontekst, në mënyrë aktive janë legjitimuar të paraqesin padi më shumë subjekte, shoqata, institucione ose organizata të tjera, të cilat kanë interes të arsyeshëm dhe të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të trajtimit të

barabartë. Të gjithë ata mund të veprojnë si ndërgjyqës dhe duhet pohimin ta bëjnë të besueshëm se me veprimin e të paditurit është cenuar e drejta e trajtimit të barabartë të grupit të personave, ose një numri më të madh të personave. Padia do të lejohet vetëm nëse ekziston pajtim nga personi i cili pohon se është diskriminuar.

Dispozita për kundërvajtje

Për të gjithë personat juridikë dhe fizikë, të cilët do të bëjnë shkeljen e dispozitave të këtij Ligji, parashikohet gjobë për kundërvajtësit.

Për çdo person që thirr ose nxitë, ose ndihmon në veprimin diskriminues do të shqiptohet gjobë në shumë prej 400-600 euro me kundërvlerë në denarë. Për kundërvajtjen e njëjtë, për personin përgjegjës në personin juridik, organin shtetëror, organin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, parashikohet gjobë në lartësi prej 600 deri 800 euro me kundërvlerë në denarë, ndërsa për personin juridik gjobë në lartësi prej 800 deri 1000 euro.

Gjobë me vlerë të njëjtë dhe për persona të njëjtë parashikohet edhe për atë i cili do ta cenojë të drejtën e dinjitetit të një personi të caktuar, ose që krijon atmosferë armiqësore, përçmuese ose frikësuese (shqetësim), si dhe për atë i cili do ta vë në gjendje të pafavorshme personin i cili e ka denoncuar diskriminimin, ose i cili në çfarëdo qoftë mënyre ka marrë pjesë në procedurën e diskriminimit (viktimizimit).

Gjithashtu, parashikohet edhe gjobë në lartësi prej 400 deri 600 euro për personin përgjegjës në personin juridik, ose organin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, nëse me kërkesë të Komisionit, në afat prej 30 ditësh, nuk paraqesin të dhëna për diskriminimin ose nuk lejojnë këqyrje në dokumente.

MBROJTJA JURIDIKE PENALE

Disa raste të diskriminimit janë shumë të rrezikshme dhe të dëmshme për shoqërinë prandaj ato paraqesin vepra penale, ndërsa kryerësit e këtyre veprave dënohen me para ose u shqiptohet dënim me burgim.

Mbrojtja juridike penale nga diskriminimi rregullohet me Kodin Penal të R. së Maqedonisë, në të cilin janë përcaktuar tri vepra penale në lidhje me ndalimin e diskriminimit edhe atë:

Cenimi i barazisë së qytetarëve (Neni 137), Cenimi i të drejtës së përdorimit të gjuhës (Neni 138), Diskriminimi racor dhe diskriminime të tjera (Neni 417). Në Kodin Penal të R. së Maqedonisë është përcaktuar edhe kapitulli i veçantë: Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit.

Organet e pushtetit publik e kanë për detyrë t'i denoncojnë veprat penale, të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, nëse në çfarëdo qoftë mënyre kuptojnë për to. Këtë detyrë e kanë edhe të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë autorizime publike ose në mënyrë profesionale merren me mbrojtjen dhe sigurimin

e njerëzve dhe pronës, me mbrojtjen shëndetësore, me rritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, nëse për atë vepër penale kanë kuptuar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Veprat penale denoncohen në polici ose në prokurorinë publike me paraqitjen e kallëzimit penal. Në zbulimin dhe procesimin e veprave penale, në përputhje me kompetencat e tyre, marrin pjesë: policia, prokuroria publike dhe gjykata.

SHEMBUJ

1. MENDIMI I KOMISIONIT PËR DISKRIMINIMIN E KONSTATUAR

Duke vepruar në kuadër të kompetencave ligjore, të pranojë dhe të shqyrtojë parashtrësia për shkak të shkeljeve të kryera të dispozitave të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhënien e mendimeve dhe rekomandimeve për raste konkrete, në përputhje me nenin 28 pika 1 dhe 2 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 50/2010 nga 13.04.2010), sipas parashtrësës së parashtruar nga personi K. A. Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më datë 10.10.2011 aprovoi këtë:

M E N D I M

Me Aktvendimin për lidhjen e kontratës së re të ndryshuar të punës në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë nr. 04-1883/1 nga data 22.03.2011, me të cilin personi A. K. sistematizohet në vendin e punës referent për lajmërimet dhe çlajmërimet të të siguruarve dhe obliguesve për pagimin e kontributit, në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë-Njësia rajonale Radovish dhe Aktvendimin për lidhjen e kontratës së re të ndryshuar të punës nr. 04-3792/1 nga data 22.06.2011 për sistematizim në vendin e punës administrator-protokollist, arkivist dhe ekspeditor dhe daktilograf në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë-Njësia rajonale Kërçovë, është bërë shqetësim, cenim të dinjitetit në bazë të moshës.

REKOMANDIM

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor që punëtori ta shlyejë cenimin e të drejtës në mënyrë që do të miratojë aktvendim për lidhjen e kontratës së re të ndryshuar të punës, me të cilin K.A. do të kthehet në vendin e punës likuidator i kompensimeve në grupin e kontrollit të të dhënave nga kontributi i SPI, kontabilitet dhe pagesa, punë administrative dhe të përgjithshme në FONDIN e SPIM-Shërbimi Profesional – Filiali Gostivar.

Rekomandimi është i detyrueshëm për Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë dhe duhet të veprojë sipas të njëjtit dhe ta shlyejë cenimin e të drejtës brenda afatit prej 30 ditësh dhe për këtë ta njoftojë Komisionin.

2. KËRKESËPADI PËR DISKRIMINIM

MIRATOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit.

KONSTATOHET se i padituri R. P. nga Sh. si drejtor i SHMK Gjumnazi “Sllavço Stojmenski” Sh. e ka cenuar të drejtën e trajtimit të barabartë të paditësit S. SH. nga Sh., e ka vënë në pozitë të pafavorshme në raport me të punësuarit e tjerë, në bazë të statusit të saj personal dhe shoqëror, përkatësisht ka kryer diskriminim të drejtpërdrejtë të përsëritur dhe të vazhdueshëm, nga nenin 12 në lidhje me nenin 3, nenin 4, paragrafin 1, nenin 6, paragrafin 1, nenin 7 paragrafin 1 nga Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

I NDALOHET të paditurit R. P. nga Sh. të ndërmerr veprime të mëtutjeshme diskriminuese ndaj paditëses S. Sh.

OBLIGOHET i padituri që me shpenzime të veta ta shpall aktgjykimin në njëerën nga gazetatat e përditshme në Republikën e Maqedonisë.

OBLIGOHET i padituri t’ia kompensojë paditëses shpenzimet e procedurës kontestimore, brenda 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjyimit, me kërcënim se do të realizohet me detyrim.

3. VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Gjykata Kushtetuese, me Vendimin U. numër. 85/2000 nga 22 nëntori i vitit 2000 e ka abroguar nenin 14, paragrafin 1 nga Ligji për sigurim shëndetësor, në pjesën “dhe mbi këtë bazë kanë sigurim shëndetësor pandërprerë më së paku gjashtë muaj para fillimit të mungesës nga puna (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 25/2000).

Me nenin e kontestuar të Ligjit, të drejtën e kompensimit të pagës gjatë kohës së mungesës nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë, është kushtëzuar me atë që sigurimi shëndetësor të jetë pandërprerë më së paku gjashtë muaj para fillimit të mungesës nga puna.

Gjykata konstatoi se:

“Me zgjidhjen e këtillë ligjore, është evidente se të siguarit – gratë të cilat shfrytëzojnë mungesë nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë janë në pozitë të pabarabartë në raport me të siguarit e tjerë të cilëve Ligji nuk ua kushtëzon të drejtën e kompensimit të pagës me kohëzgjatjen e sigurimit. Gjykata konsideron se të drejtat e të siguarve, të cilat rezultojnë nga sigurimi shëndetësor, duhet të jenë të njëjta për të gjithë të siguarit. Keqpërdorimi i kësaj të drejte nga ana e personave të caktuar (që nuk është karakteristikë vetëm e grave – shtatzëna) nuk mund të jetë bazë që kjo kategori e të siguarve të vihet në pozitë më të pafavorshme nga të tjerët, sidomos nëse merret parasysh roli i nënës në reproduksionin biologjik dhe nevoja e fëmijëve për t’u krijuar kushte për zhvillim normal, si dhe detyrimi kushtetues i Republikës për mbrojtjen e amësisë dhe fëmijëve”.

4. Vepra penale për mbrojtjen nga diskriminimi në KP të R. të Maqedonisë

Cenimi i barazisë së qytetarëve

Neni 137

(1) Ai që në bazë të dallimit të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës kombëtare dhe shoqërore, bindjes politike dhe fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore, gjuhës dhe veçorisë tjetër personale, ose rrethanave, do t'ia heq ose do t'ia kufizojë të drejtat e njeriut dhe qytetarit, të përcaktuara me Kushtetutë, me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, ose i cili në bazë të këtyre dallimeve qytetarëve u jep privilegje në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjin, ose me marrëveshjen e ratifikuar ndërkombëtare, do të dënohet me dënim me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

(2) Nëse veprën nga paragrafi 1 e kryen personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, do të dënohet me dënim me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(3) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me para.

Cenimi i të drejtës së përdorimit të gjuhës dhe të alfabetit

Neni 138

(1) Ai që qytetarëve do tua heq, ose do tua kufizojë me Kushtetutë, ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare të drejtën e garantuar të përdorimit të gjuhës dhe të alfabetit, do të dënohet me dënim me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

(2) Nëse veprën nga paragrafi 1 e kryen personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, do të dënohet me dënim me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(3) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me para.

Diskriminimi racor dhe diskriminime të tjera

Neni 417

(1) Ai që në bazë të dallimit të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës nacionale ose etnike i cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të njohura nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, do të dënohet me dënim me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(2) Me dënimin nga paragrafi 1 do të dënohet ai i cili bën persekutimin e organizatave, ose individëve për shkak të angazhimit të tyre për barazinë e njerëzve.

(3) Ai i cili përhap ide për superioritetin e një race mbi tjetrën, ose përhap urrejtje racore, ose nxit diskriminim racor, do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

KAPITULLI I TRETË

PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË LIDHJE ME RASTET PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Atanas Georgievski

PRAKTIKA GJYQËSORE E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË LIDHJE ME RASTET E MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga data 10 prill 1997, është pjesë përbërëse e rregullimit juridik vendas dhe ajo nuk mund të ndryshohet me ligj (Neni 118 nga Kushtetuta). Duke e marrë parasysh se gjykatat vendosin në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në përputhje me Kushtetutën (Neni 98 nga Kushtetuta), rezulton se ato mund ta zbatojnë drejtpërdrejt Konventën gjatë vendimmarrjes sipas lëndëve konkrete. Meqë praktika gjyqësore e Gjykatës është ajo që i jep përmbajtje Konventës dhe në të cilën janë përkufizuar principet themelore në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Konventë, padyshim që mund të konkludohet se gjykatat, në arsyetimin e aktgjykimeve të tyre, mund të thirren në këtë praktikë gjyqësore. Kjo ka të bëjë jo vetëm me aktgjykimet e Gjykatës në lidhje me Republikën e Maqedonisë, por edhe me praktikën e përgjithshme gjyqësore të kësaj gjykate, për arsye se krahas veprimit inter partes aktgjykimet e Gjykatës së Strasburgut përmbajnë opinionet parimore juridike për çështje të caktuara, të cilat i tejkalojnë kufijtë e shtetit të interesuar dhe janë universal.

Ndalim i përgjithshëm i diskriminimit:

Neni 14 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 14 është dispozita e fundit e Katalogut për të drejtat dhe liritë të cilat i përcakton Konventa. Kjo dispozitë e parashikon ndalimin e diskriminimit. Në përputhje me të njëjtën “Gëzimi i të drejtave dhe lirive, të parapara me këtë Konventë, do të sigurohet pa kurrfarë diskriminimi në bazë të: gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësisë së minoritetit kombëtar, pozitës materiale, prejardhjes sipas lindjes, ose çdo statusi tjetër”.

Nëse teksti i kësaj dispozite dhe mënyra e formulimit shqyrtohet me vëmendje, do të vihet re se ka rol akcesues, plotësues përkatësisht parashikon ndalim të diskriminimit vetëm sa i përket “gëzimit të të drejtave dhe lirive të përcaktuara me Konventën”. Gjykata nuk do t’i pranojë si të lejuara të dhënat ankimore për diskriminim nëse aplikuesit në mënyrë të izoluar thirren vetëm në këtë dispozitë. Suksesi mund të arrihet vetëm nëse aplikuesi kërkon përcaktimin e shkeljes së Nenit 14 në lidhje (“in conjunction with”) me ndonjë dispozitë tjetër substanciale nga Konventa. Kjo do të thotë se dispozita ka një pozicion “parazit” në raport me dispozitat e tjera substanciale nga Konventa. Ajo nuk ekziston në mënyrë të pavarur dhe zbatimi i saj është i lidhur me të drejtat dhe liritë e tjera të përcaktuara me Konventë. Kështu, në lëndën *Marckx v. Belgium* (1979), § 32, Gjykata do të deklarohet:

“Neni 14 i plotëson dispozitat e tjera substanciale të Konventës dhe protokolleve. Neni 14 nuk ekziston në mënyrë të pavarur, për arsye se kjo dispozitë ka efekt vetëm në lidhje me “gëzimin e të drejtave dhe lirive” të cilat mbrohen me ato dispozita”.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Neni 14 është dispozitë pasive, pa kurrfarë roli në implementimin praktik të Konventës.

Praktika gjyqësore konfirmon se Gjykata mund të përcaktojë shkelje të Nenit 14 (në lidhje me ndonjë dispozitë tjetër) madje edhe në situatë kur nuk ekziston shkelje e dispozitës në fjalë. Kjo do të thotë se, ndonëse Neni 14 është i natyrës komplementare, megjithatë ka autonomi të caktuar. Kështu, për shembull, në lëndën *Rasmussen v. Denmark* (1984), §29, Gjykata ka deklaruar:

“Edhe pse zbatimi i Nenit 14 nuk nënkupton domosdoshmërisht shkelje të dispozitave (substanciale) – dhe deri në atë shkallë ka domethënie autonome – nuk mund të ketë hapësirë për zbatimin e tij përveç nëse faktet e prezantuara nuk bëjnë pjesë në kuadër të njëres ose të më shumë dispozitave të mëvonshme”. Siç u tha më lart në tekst, ajo që e zgjeron zbatimin e Nenit 14 në praktikë është interpretimi i gjerë të cilin e jep Gjykata në lidhje me të drejtat dhe liritë e parashikuara me Konventën. Përmes këtij interpretimi shumë të drejta dhe liri, të cilat në mënyrë eksplicite nuk janë cekur në Konventë, megjithatë nuk mbeten jashtë përfshirjes së mbrojtjes të cilën e ofron Neni 14. Në lëndën *Okpiz v. Germany* (no. 59140/00, § 31), Gjykata e ka deklaruar qëndrimin si vijon:

“Neni 14 hyn në lojë gjithmonë kur “çështja e padrejtësisë paraqet një nga modalitetet e realizimit të së drejtës së garantuar”, ose nëse masat për të cilat paraqitet padia “kanë të bëjnë me realizimin e të drejtës së garantuar”. Interpretimin e gjerë, të cilin e jep Gjykata në lidhje me të drejta dhe liri të caktuara, është më i dukshëm sa i përket të drejtës së jetës private, të përcaktuar në Nenin 8 të Konventës. Kështu, kjo e drejtë përfshin në vetvete edhe një sërë nën-të drejta, ose aspekte të të drejtës së jetës private, të cilat nuk janë cekur në mënyrë eksplicite në Konventë, por praktika gjyqësore i ka kristalizuar si elementë përbërës të të drejtës së privatësisë.

Nocioni “jetë private” me domethënien e Nenit 8 të Konventës është koncept i gjerë i cili, mes tjerash, përfshin të drejtën e vendosjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve me njerëz të tjerë. Këtu përfshihen elementet siç janë: emrat, identifikimi gjinor, orientimi seksual dhe jeta seksuale, të cilat bëjnë pjesë në kuadrin të sferës personale, e cila mbrohet me Nenin 8, si dhe të drejtës së respektimit të vendimit për të pasur ose për të mos pasur fëmijë.” (*E.B. v. France* [GC], no. 43546/02, § 43).

Në këtë kontekst, sipas interpretimit të Gjykatës, ndalimi i përgjithshëm i punësimit në sektorin privat të personave, të cilët në të kaluarën kanë bashkëpunuar me shërbimet sekrete të shtetit, paraqet sulm mbi të drejtën e

jetës private (Sidabras and Džiautas v. Lithuania, nos. 55480/00 and 59330/00). Gjithashtu, edhe e drejta e përdorimit të mbiemrit të vajzërisë (që për aplikuesen ka qenë me rëndësi për shkak të kryerjes me sukses të profesionit të avokates) bën pjesë në fushëveprimin e të drejtës së privatësisë (Unal Tekeli v. Turkey, no. 29865/96). Apo, jashtë nga konteksti i të drejtës së jetës private, Gjykata ka pranuar se detyra për të qenë gjyqtar-porotë bën pjesë në kuadër të Nenit 4 të Konventës (Zarb Adami v. Malta, no. 17209/02).

Megjithatë, duhet të potencohet se Neni 14 është i hapur dhe ai parashikon ndalim të diskriminimit jo vetëm sipas atyre bazave që janë përcaktuar në mënyrë taksative në këtë nen. Kjo është kështu sepse ky nen e siguron gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara me këtë Konventë pa diskriminim të bazuar mbi “cilindo qoftë status tjetër”. Kjo do të thotë se kjo dispozitë parashikon një listë të hapur të bazave diskriminuese, të cilat edhe pse nuk janë cekur në mënyrë eksplicite, megjithatë janë pjesë të kësaj dispozite. Kjo rezulton nga praktika e Gjykatës në të cilën si baza diskriminuese, përveç atyre bazave “të mbrojtura” të cilat janë numëruar në mënyrë eksplicite në Nenin 14 të Konventës, paraqitet edhe diskriminimi i bazuar mbi orientimin seksual, përkatësinë gjinore, moshën, handikapun dhe ngjashëm (për këtë më shumë në vazhdim, në pjesën që u kushtohet bazave të diskriminimit).

Në situatë kur ka të dhëna ankimore për shkelje të Nenit 14, në lidhje me ndonjë dispozitë tjetër nga Konventa, Gjykata më së shpeshti vepron në dy mënyra: së pari merret me analizimin e të dhënave ankimore në lidhje me dispozitën “kryesore” nga Konventa në të cilën thirret ankuesi. Nëse Gjykata konstaton shkelje të kësaj dispozite, ajo mund të konkludojë se nuk është e nevojshme të analizohen të dhënat ankimore në lidhje me Nenin 14 (Airey v. Ireland (1979); Dudgeon v. the United Kingdom (1981); Keegan v. Ireland (1994); Philis v. Greece (no. 1) (1991); Castells v. Spain (1992); Elsholz v. Germany [GC], no. 25735/94; Kroon and Others v. the Netherlands (1994), veçanërisht të gjejë shkelje të Nenit 14 (në lidhje me ndonjë dispozitë tjetër) dhe të mos merret me dispozitën “kryesore” (Hoffmann v. Austria (1993); Burghartz v. Switzerland (1994); Gaygusuz v. Austria 1(1996); Mazurek v. France (1997).

Ajo që është e përbashkët gjatë vendimmarrjes është se Gjykata do të fillojë me analizimin e të dhënave ankimore në lidhje me Nenin 14 nga Konventa “vetëm nëse ekziston pabarazi e qartë në trajtimin gjatë gëzimit të të drejtës për të cilën bëhet fjalë, ndërkaq ajo e paraqet aspektin fundamental të lëndës” (Airey v. Ireland, 1979, § 30).

Ndalim i përgjithshëm i diskriminimit: Neni 1 i Protokollit nr. 12

Neni 1 i Protokollit 12 nga Konventa parashikon se “gëzimi i çdo të drejtë të parashikuar me ligj do të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër,

origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja, ose çdo status tjetër. Askush nuk duhet të diskriminohet nga asnjë autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1”.

Është evidente se kjo dispozitë i cek të njëjtat baza të diskriminimit, të cilat janë përmendur në Nenin 14 të Konventës. Megjithatë, kjo dispozitë përmban një dallim esencial, ndërkaq ky është se ajo e ndalon diskriminimin në gëzimin e “çdo të drejte të përcaktuar me ligj”. Kjo dispozitë ka për qëllim zgjerimin e ndalimit të diskriminimit dhe përgjithësimin e saj, jo vetëm sa u përket të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Konventë, por edhe të atyre që parashikohen me të drejtën vendase. Në Komentin e Protokollit nr. 12, të miratuar nga Këshilli i Evropës (Explanatory Report to Protocol No. 12) nënvizohet se kjo dispozitë e ndalon diskriminim gjatë gëzimit: 1) të të gjitha të drejtave individuale të përcaktuara me të drejtën vendase; 2) të cilësdo qoftë të drejte individuale që rezultojn nga ndonjë obligim i pushtetit; 3) të cilësdo qoftë të drejte e cila është rezultat i autorizimeve të diskrecionit të autoriteteve shtetërore; dhe 4) të cilësdo qoftë të drejte e cila do të rezultojë nga ndonjë veprim ose mosveprim i organeve shtetërore. Kjo dispozitë nuk ka të bëjë vetëm me obligimin e shteteve që ta parandalojnë diskriminimin e kryer nga ana e organeve shtetërore, por edhe kur ai ndodh në marrëdhëniet private-juridike. Neni 1 i Protokollit nr. 12, nuk ka për qëllim ta zëvendësojë Nenin 14, por vetëm ta plotësojë zbatimin e tij dhe së këtejmi duke e pasur parasysh praktikën tanimë të vendosur të Gjykatës. Ai nuk e abrogon Nenin 14 i cili vazhdon edhe më tej të zbatohet. Edhe pse këto dy dispozita mund të mbivendosen, Gjykata është ajo e cila e jep interpretimin përfundimtar të të dhënave ankimore në dritën e fakteve të rastit.

Megjithëkëtë, mbetet konkluzioni se qëllimi i Nenit 1 të Protokollit nr. 12 është ta shmangë “mangësinë” e Nenit 14 duke parashikuar një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit gjatë gëzimit të çdo lloji të drejte, pa dallim nëse e njëjta është përcaktuar në Konventë ose jo. Kjo dispozitë nuk parashikon ndonjë princip të ri të interpretimit, standard të ri të mbrojtjes nga diskriminimi, por vetëm e zgjeron vëllimin e ndalimit, fillimisht të parashikuar me Nenin 14 të Konventës. Mund të pritët se kur një person do të ankohet për diskriminim të supozuar sipas të dyja dispozitave, Gjykata do të përcaktohej për zbatimin e Nenit 14 nëse diskriminimi ka të bëjë me gëzimin e ndonjë të drejte, ose të lirive të parashikuara në Konventë. Në të kundërtën, po qe se bëhet fjalë për diskriminim të supozuar në gëzimin e të drejtës, ose të lirisë, që nuk është parashikuar në Konventë, të dhënat e diskriminimit do të analizoheshin sipas Nenit 1 nga Protokollit nr. 12.

Në mbështetje të kësaj është lënda Sejdić and Finci v. Bosnia and Herzegovina [GC], nos. 27996/06 and 34836/06, e cila deri më tani është lënda e vetme në të cilën Gjykata ka konstatuar shkelje të Nenit 1 nga Protokollit nr. 12. Bëhet fjalë për aplikim të paraqitur nga dy shtetas të Bosnjë e Hercegovinës, njëri rom, ndërsa tjetri hebre. Ata janë ankuar para Gjykatës se janë diskriminuar mbi bazë racore, përkatësisht mbi bazë etnike dhe meqë nuk kanë mundur, për shkak

të përkatësisë së tyre etnike, ta realizojnë të drejtën e tyre pasive të zgjedhjes, përkatësisht të paraqiten si kandidatë për anëtar të Parlamentit Shtetëror dhe Kryesisë Federale. Kjo ka ndodhur për shkak se në përputhje me Kushtetutën e Bosnjë e Hercegovinës vetëm pjesëtarët e tre popujve konstituiv të Bosnjë e Hercegovinës (serbë, kroatë dhe boshnjakë) kanë mundur të kandidohen për këto funksione.

Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 14, ndërsa në lidhje me gëzimin e të drejtës së zgjedhjeve të lira parlamentare, të parashikuara në nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës (në lidhje me mundësinë të kandidohen për anëtar të Parlamentit) dhe shkelje të nenit 1 nga Protokollit nr. 12 (në lidhje me të drejtën për t'u kandiduar për anëtar të Kryesisë Federale).

Diskriminimi i drejtpërdrejtë sipas KEDNJ

Konventa nuk jep përkufizim për diskriminim e drejtpërdrejtë. Megjithatë, në lëndën Willis v. United Kingdom, no.36042/97, Gjykata ka deklaruar:

“Neni 14 i Konventës siguron mbrojtje nga diskriminimi, përkatësisht trajtim të ndryshëm, pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave të cilët gjenden në pozita relevante të ngjashme”.

Krahas kësaj, i ashtuquajhuri përkufizim pozitiv, ku kërkohet trajtimi i barabartë i personave në pozitë të ngjashme, në praktikën e Gjykatës paraqitet edhe një interpretim i diskriminimit të drejtpërdrejtë, ndërkaq i njëjti ka të bëjë me situatat kur personat në pozitë të ndryshme duhet të trajtohen në mënyra të ndryshme deri në nivelin e nevojshëm që ata të kenë kushte për ta gëzuar të drejtën dhe lirinë. Në këto raste, domethënë, mund të bëhet fjalë për diskriminim nëse persona në pozita të ndryshme kanë trajtim të njëjtë. Kështu, në lëndën Thlimmenos v. Greece, Gjykata ka konstatuar se: “E drejta që të mos diskriminohet, gjithashtu cenohet kur shtetet pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm nuk arrijnë të veprojnë në mënyra të ndryshme me personat pozita e të cilëve ndryshon në masë të konsiderueshme”.

Në këtë lëndë aplikuesit nuk i është lejuar të anëtarësohet në Shoqatën e Kontabilistëve të Autorizuar meqë në të kaluarën ka qenë i dënuar për shkak të “jolojalitetit” (insubordination) për shkak se ai, si dëshmitar i Jehovahit, ka refuzuar të mbajë uniformë ushtarake në kohën e shërbimit ushtarak. Gjykata konstatoi se kjo Shoqatë, duke e refuzuar aplikimin e ankuesit, mbi këtë bazë nuk ka bërë distinkcion midis tij dhe personave të tjerë të dënuar, duke e marrë parasysh se dënimi i tij është bazuar ekskluzivisht mbi ndjenjat e tij fetare. Gjykata konstatoi se fakti që aplikuesi nuk është trajtuar ndryshe nga personat e tjerë të dënuar edhe përkundër asaj se dënimi i tij është bazuar mbi ndjenjat e tij fetare dhe si i këtillë, i ndryshëm nga dënimi i personave të tjerë, ai ka qenë objekt i diskriminimit i cili ka qenë joproporcional dhe nuk ka përmbushur kurrfarë qëllimi legjitim. Nga këto përkufizime shihet qartë se kur bëhet fjalë për diskriminim të drejtpërdrejtë,

trajtimi i pabarabartë është në qendër të vëmendjes. Megjithëkëtë, nuk do të thotë se çdo formë e trajtimit të pabarabartë paraqet diskriminim. Në Belgian Linguistics case (1968), Gjykata ka deklaruar se Neni 14 nuk kërkon nga shtetet të ndalojnë çdo lloj trajtimi të ndryshëm të qytetarëve të tyre. Përkundrazi, në situata të caktuara trajtimi i ndryshëm imponohet si nevojë legjitime me qëllim të tejkalimit të dallimeve të caktuara të cilat ekzistojnë në shoqëri. Ajo që është me rëndësi në lidhje me diskriminimin është të punohet për trajtimin e pabarabartë të personave të cilët gjenden në pozitë dytësore.

Trajtimi i pabarabartë mund të jetë problematik nga aspekti i ndalimit të diskriminimit vetëm nëse personat, të cilët ndodhen në pozitë të njëjtë ose të ngjashme me persona të tjerë, trajtohen në mënyrë më të pavaforshme në krahasim me shembuj të ngjashëm. Kur flasim për trajtim të ndryshëm të personave në pozitë krahasuese, duhet të potencohet se ky krahasim bëhet në lidhje me ndonjë veçori të caktuar të personave, sipas të cilës ata dallojnë nga njëri tjetri. Në lëndën Kjeldsen v. Denmark (1976), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut potencoi se me Nenin 14 ndalohet “trajtimi diskriminues për të cilin bazë ose shkak paraqet veçoria personale (“statusi”) sipas së cilës personat ose grupi i personave dallojnë ndërmjet tyre.”

Komparator është personi i cili është me status relativisht identik me personin i cili ankohet se është objekt i praktikës diskriminuese, ndërsa dallimi i vetëm mes tyre është ndonjë veçori e caktuar për shkak të së cilës personi, objekt i observimit, është trajtuar ndryshme nga komparatori i tij. Në lëndën Fredin v. Sweden, Gjykata ka deklaruar: “Që konfirmimi të jetë i suksesshëm për shkelje të Neni 14, doemos duhet, mes tjerash, të përcaktohet se pozita e viktimës së supozuar mund të konsiderohet se është e ngjashme me pozitën e personave të cilët janë trajtuar më mirë”.

Parimisht, në praktikë nuk është vështirë të përcaktohet komparatori i këtyre. Megjithatë, barra e provës dhe e identifikimit të komparatorit bie mbi ankuesin, përkatësisht mbi atë që pohon se është viktimë e diskriminimit. Nga praktika gjyqësore e Gjykatës:

- Shtetasi i huaj (maroken) nuk është në pozitë identike me shtetasit vendas, sa i përket mundësisë të ekstradimit nga shteti në të cilin kërkon azil (për shkak se ka qenë i dënuar për vepër penale). Edhe pse Gjykata ka konstatuar se aplikuesi është në pozitë të ngjashme, sa i përket mundësisë për ekstradim, me shtetasit e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (të cilët gjithashtu sikurse edhe shtetasit vendas nuk kanë mundur të ekstradohen për shkak të legjislacionit të BE-së, i cili e garanton lirinë e lëvizjes së kësaj kategorie të qytetarëve), megjithatë ka konstatuar se trajtimi i këtyre është i arsyeshëm (Moustaquim v. Belgium);
- Personat në lidhje gjaku (në lëndën me dy motrat) nuk janë në pozitë të barabartë me bashkëshortët e tyre, me të cilët janë në lidhje martesore

ose jashtëmartesore (të cilët gjithashtu jetojnë në bashkësinë e njëjtë familjare) në lidhje me të drejtën e fitimit të pronësisë përmes trashëgimit të pronës së fituar gjatë jetës së përbashkët në bashkësi. Arsyeja për këtë është se martesë dhe partneriteti civil paraqesin bashkësi të veçanta, në të cilën hyhet vullnetarisht dhe me vetëdije dhe të cilat krijojnë të drejta dhe obligime të caktuara kontraktuese të cilat nuk ekzistojnë ndërmjet personave në lidhje gjaku (Burden v. UK):

- Avokatët, të cilët kanë qenë të obliguar që, konform legjislacionit vendas në fillim të karrierës së tyre, të ofrojnë shërbime avokatie pro bono, nuk mund të barazohen me profesionet e tjera (noterë, kontabilistë) për të cilët obligimi pro bono nuk ka ekzistuar (Van der Musselle v. Belgium).

Sipas së drejtës evropiane, diskriminim i drejtpërdrejtë është kur një njeri trajtohet në mënyrë më të pafavorshme sesa një njeri tjetër, kur ai njeri është ose do të ishte trajtuar në situatë krahasuese në bazë të veçorisë mbrojtëse të tij/saj.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të jetë evident si në rastin ose i kamufluar, (diskriminim evident ose i kamufluar). Një skenar tipik për diskriminim të kamufluar është kur baret ose klubet kanë politikë që hyrja të jetë e lejuar vetëm për ata të cilët janë të anëtarësuar, por ky anëtarësim nuk bëhet në mënyrë neutrale nga aspekti racor.

Kohë më parë, Gjykata Evropiane e Drejtësisë identifikoi diskriminim të drejtpërdrejtë në rastet në të cilat kriteri formal neutral, në të vërtetë e prekte vetëm një grup – sipas natyrës së vet ose në bazë të rregullit i cili ka fuqinë e ligjit.

Ligji në Gjermani u lejon çifteve të gjinisë së njëjtë të formojnë partneritet, por jo edhe të martohen. Zoti Maruko, pas vdekjes së partnerit të tij i cili kishte paguar kompensim për sigurim pensional në fondin për pension, ka paraqitur kërkesë pranë fondit për ta marrë pensionin e partnerit të tij, por ishte refuzuar nga ana e fondit. Në vendimin për interpretimin e ligjit, Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka vendosur se Direktiva kornizë për punësim, në rastin konkret është e zbatueshme. Gjithashtu, Gjykata ka vendosur se partnerët e gjinisë së njëjtë, të cilët janë në partneritet, kanë qenë në situatë të krahasueshme me bashkëshortët kur bëhet fjalë për pagimin e pensionit nga fondi partnerit i cili akoma jeton (Case C-267/06 Maruko). Ky vendim i Gjykatës tanimë është zbatuar nga ana e Gjykatës Federale të Gjermanisë për konteste pune në rast tjetër (Az: 3 ATR 20/07, 14.01.2009).

Diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të jetë i ligjshëm kur ligji evropian lejon përjashtim ndaj principit të përgjithshëm për mosdiskriminim, por zbatohen përjashtime të ndryshme për baza të ndryshme të mbrojtjes. Kjo do të thotë se kur trajtimi i pabarabartë do të identifikohet si diskriminim i drejtpërdrejtë, para së gjithash nevojitet para se të ndërmerret ndonjë veprim, të kontrollohet nëse është i aplikueshëm ndonjë përjashtim në rastin konkret.

Në përgjithësi, më së vështiri është të arsyetohet diskriminimi i drejtpërdrejtë racor ose etnik, ndërkaq diskriminimi i drejtpërdrejtë i cili bazohet mbi pengesat ose moshën mund të arsyetohet më lehtë. Përjashtimet për principin e trajtimit të barabartë të cilët janë të lejuar sipas Direktivës për Mosdiskriminim, në masë të madhe janë inkorporuar në Ligjin nacional. Në disa raste ekziston dyshimi se ato përjashtime janë gjithëpërfshirëse sesa që e lejojnë direktivat.

Diskriminimi i tërthortë sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Njësoj, sikurse edhe diskriminimin e drejtpërdrejtë, Konventa nuk e parashikon e as nuk e përkufizon diskriminimin e tërthortë. Megjithatë, Gjykata e detekton diskriminimin e tërthortë, me ç'rast në qendër të vëmendjes nuk është trajtimi i pabarabartë, por efektet nga trajtimi i tillë, të cilat njerëzit në pozita të ndryshme, i ndejnë në mënyrë të ndryshme. Kështu, “dallimi gjatë veprimit mund të jetë në formë të efekteve joproporcionale arbitrare të politikës së përgjithshme ose masë, e cila e shprehur në mënyrë neutrale bën diskriminimin e grupit”. (D.H. and Others v. the Czech Republic [GC], No. 57325/00; Opuz v. Turkey, No. 33401/02; Zarb Adami v. Malta, No. 17209/02).

Mbase lënda e parë në të cilën Gjykata e ka pranuar ekzistimin e diskriminimit të tërthortë është Hugh Jordan v. the United Kingdom, no. 24746/94. Në këtë lëndë, sipas aplikuesit, rrethanat nën të cilat është vrarë djali i tij nga forcat e sigurisë së Britanisë së Madhe çojnë në ekzistimin e diskriminimit mbi bazë të përkatësisë fetare.

Përkatësisht, aplikuesi është ankuar se shumica e personave të vrarë në Irlandën Veriore, gjatë periudhës midis viteve 1969 dhe 1994, kanë qenë persona të rinj pjesëtarë të komunitetit katolik, për dallim nga protestantët, numri i të cilëve ka qenë i pakonsiderueshëm. Në mbrojtje të argumentit të këtillë ka deponuar edhe të dhëna statistikore të cilat kanë vënë në pah tendencën e këtillë.

Qeveria i ka mohuar pohimet e këtilla duke theksuar se të dhënat joprecize statistikore nuk janë provë e mjaftueshme për bërjen e çfarëdo qoftë analogjie të vrasjeve, ose aq më tepër trajtimi të ndryshëm. Gjykata, edhe përkundër faktit se nuk i ka pranuar të dhënat statistikore si prova të besueshme, megjithatë ka deklaruar se “Kur një politikë e përgjithshme ose masë ka efekte joproporcionale arbitrare, mbi një grup të caktuar, nuk përjashtohet mundësia se një gjë e tillë mund të konsiderohet si diskriminuese edhe pse nuk është dedikuar në mënyrë konkrete, ose është drejtuar ndaj atij grupi”.

Më vonë, në lëndën e Zarb Adami v Malta (2006) Gjykata e ka plotësuar përkufizimin e diskriminimit të tërthortë duke deklaruar se “diskriminimi i cili në mënyrë potenciale është në kundërshtim me Konventën mund të rezultojnë jo vetëm nga një masë ligjore, por gjithashtu edhe nga situata de facto”.

Në përputhje me legjislacionin vendas të Maltës, gjyqtar-porotë mund të

ishte çdo shtetas maltezë i moshës madhore, i cili e ka zotëruar gjuhën malteze dhe i cili ka karakter të mirë. Nga ky obligim janë liruar, mes tjerash, ata persona të cilët kujdesen për familjen. Gjykata ka konstatuar se kushtet për ushtrimin e funksionit gjyqtar-porotë për nga natyra janë neutrale. Megjithatë, aktgjykimin e vet e ka bazuar mbi të dhënat statistikore sipas së cilave ka pasur mbi 4 mijë gjyqtarë-porotë meshkuj, kundrejt vetëm 5 gjyqtareve-porotë femra. Në përqindje kjo do të thotë se mbi 95% e gjyqtarëve-porotë në Maltë kanë qenë meshkuj, edhe pse shumica e qytetarëve të moshës madhore kanë qenë femra. Së këtejmi, Gjykata konstatoi se mënyra e përpilimit të listave për gjyqtarë-porotë në Maltë dhe kushtet me të cilat një person mund të lirohet nga ky obligim kanë qenë diskriminuese, duke i vënë meshkujt në pozitë më të pavoritshme në raport me femrat. Ajo nuk e pranoi argumentin e shtetit se praktika e këtillë është e kushtëzuar nga vlerat tradicionale të shoqërisë malteze, në të cilën femrat kanë qenë ato të cilat janë kujdesur për familjen dhe për faktin se tek avokatët ka ekzistuar praktika që më shumë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtareve-porotë femra. Domethënë, në këtë lëndë, nuk ka qenë problematike ndonjë dispozitë ligjore, por një praktikë rezultatet e së cilës kanë ndikuan në drejtim të diskriminimit të meshkujve në raport me femrat.

Duke i marrë parasysh këto lëndë, mund të përfundohet se elementi i parë gjatë analizës së këtij lloji më kompleks të diskriminimit është ekzistimi i dispozitës, kriterit ose praktikës, në shikim të parë neutral, të cilët edhe pse zbatohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë, megjithatë, duke i pasur parasysh pasojat të cilat i gjenerojnë, individët ose pjesëtarët e një grupi të caktuar i vënë (sipas karakteristikave të caktuara) në një pozitë më të pavoritshme në raport me personat e tjerë (komparatorë).

Elementi i dytë, i cili duhet të përcaktohet, është ekzistimi i pasojave të dëmshme disproporcionale për individin, ose për pjesëtarët e grupit nga zbatimi i dispozitave, kriterëve dhe praktikave, në shikim të parë neutrale. Pikërisht këtu është dallimi thelbësor ndërmjet diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Thëksi tek i dyti është vënë në ekzistimin e pasojave të dëmshme nga legjislati i caktuar ose nga praktika dhe jo nga trajtimi i pabarabartë. Domethënë, fokusi i vëmendjes është zhvendosur në drejtim të efekteve të ndryshme në praktikë. Ky lloj diskriminimi, duke e pasur parasysh specifikën e tij, më vështirë mund të dëshmohet dhe në të shumtën e rasteve, si instrument bazë shfrytëzohen të dhënat statistikore të cilat, nëse janë të besueshme, reprezentative dhe bindëse, mund të shërbejnë si bazë, apo edhe si provë thelbësore për përcaktimin/ekzistimin e diskriminimit të tërthortë. Për fuqinë provuese të të dhënave statistikore do të bëhet fjalë në pjesën e cila ka të bëjë me aspektet praktike dhe me provat të cilat mund të shfrytëzohen në procedurën e konstatimit të diskriminimit të tërthortë. Gjithsesi, në fund të analizës edhe tek ky lloj i diskriminimit pason testi i proporcionalitetit sipas së cilit do të duhet të përcaktohet nëse dispozita, kriteri ose praktika e tillë objektivisht është e

justifikueshme, përkatësisht se a ekziston ndonjë qëllim legjitim dhe masat të cilat janë objekt të observimit a janë përkatëse dhe domosdoshmërisht të nevojshme për arritjen e tij.

Përkufizim i përgjithshëm për diskriminimin e tërthortë në të drejtën evropiane është: kur një dispozitë, kriter ose praktikë kinse neutrale, njerëzit të cilët ndajnë veçori të mbrojtur i vë në pozitë të caktuar të padrejtë krahasuar me njerëzit e tjerë.

Ajo që përgjithësisht mund të shihet si diskriminim i tërthortë, shpeshherë bazohet mbi ligjin, sepse ligji evropian lejon një përjashtim të përgjithshëm të përkufizimit të cekur më lart mbi bazë të qëllimit të dispozitës, kriterit ose praktikës. Me këtë përjashtim të përgjithshëm shtrohet pyetja: pse është miratuar një dispozitë, kriter ose praktikë e caktuar, cili ka qenë qëllimi? Gjithashtu, shtrohet pyetja, nëse mënyra, modeli, zgjidhja e cila shfrytëzohet për këtë praktikë është e domosdoshme dhe përkatëse? Ose: a mund të arrihet qëllimi në një mënyrë tjetër?

Diskriminimi i tërthortë është i ligjshëm nëse dispozita, kriteri ose praktika munden në mënyrë objektive të justifikohen me qëllimin legjitim, ndërkaq mënyra e arritjes së atij qëllimi është përkatëse dhe e domosdoshme. Këtë duhet ta dëshmojnë të akuzuarit, por gjithashtu për viktimat është e nevojshme të kontrollojnë nëse atë që ata e konsiderojnë se është diskriminim, në të vërtetë është parashikuar me ligj. Në praktikë ekzistojnë juridiksione nga më të ndryshmit në të cilët mund të vendoset se një tip i caktuar i diskriminimit të tërthortë është i ligjshëm sipas ligjit evropian. Megjithatë, ekzistojnë principe të caktuara të cilat e bëjnë kufizimin se cilat juridiksione janë të pranueshme:

- Vetëm shqyrtimet buxhetore (financiare) asnjëherë nuk mund të shërbejnë si justifikim objektiv për diskriminim.
- Qëllimi i praktikës së këtillë nuk guxon të ndërlihet me diskriminimin dhe nuk mjafton vetëm përgjithësimi.
- Proporcionaliteti nënkupton se ndërmarrja e masave konkrete duhet të jetë përkatëse për arritjen e qëllimit të këtillë.
- Proporcionaliteti gjithashtu nënkupton se i akuzuari duhet të tregojë se një masë tjetër, me efekt dëmtues më të vogël ose pa efekt dëmtues, nuk do të ishte efektive.

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me provat dhe barrën e provës

Diskriminimi nuk manifestohet hapur, e as nuk mund të identifikohet në mënyrë të thjeshtë. Dëshmimi i diskriminimit është i vështirë, madje edhe kur trajtimi i pabarabartë bazohet në ndonjë veçori të individit ose grupit. Kjo është kështu për shkak se trajtimi i ndryshëm ose nuk manifestohet në mënyrë eksplicite ose

ai në mënyrë artificiale ndërlidhet me disa faktorë të tjerë të cilët diskriminimin e kamuflojnë. Është e vështirë të dëshmohet diskriminimi për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesave ndërmjet ankuesit dhe kryerësit të presupozuar të diskriminimit.

Pikërisht për shkak të vështirësive karakteristike për procesin e dëshmimit të diskriminimit, principi i ndarjes së barrës së provës ndërmjet të dyja palëve të përfshira në proces, viktimës së supozuar dhe kryerësit të diskriminimit, është i pranishëm në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Sipas këtij principi, nëse viktima e supozuar arrin ta dëshmojë prezumimin e diskriminimit, përkatësisht ta bëjë të besueshëm ekzistimin e diskriminimit, në rast të këtyre barra e provës bie në anën e kryerësit se nuk ka ekzistuar diskriminim. Kjo bartje e barrës së provës është jashtëzakonisht e rëndësishme në procesin e dëshmimit të diskriminimit të tërthortë ku duhet të dëshmohet se një rregull ose praktikë (mënyrë) e sjelljes ka pasur pasoja negative joproportionale mbi individ të caktuar ose grup.

Gjykata është ajo që mbi bazë të provave të përgjithshme materiale do të vendos nëse ekziston diskriminim dhe nëse i njëjti është i arsyeshëm. Gjykata do t'i pranojë si të verifikuara ato pohime të cilat:

„mbështeten nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave, përfshirë edhe konkluzionet të cilat mund të rezultojnë nga faktet dhe nga të dhënat e palëve. Provat mund të rezultojnë nga koekzistenca e konkluzioneve mjaftueshëm të fuqishme, të qarta dhe të harmonizuara ose konkluzione të ngjashme të pakontestueshme, të cilat rezultojnë nga fakte të tjera. Krahas kësaj, niveli i bindjes i cili është i domosdoshëm për të arritur deri në një konkluzion të caktuar dhe në lidhje me këtë, shpërndarja e barrës së provës, ndërlidhet në mënyrë tipike me specifikat e fakteve, me natyrën e të dhënave ankimore dhe me të drejtën e Konventës për të cilën bëhet fjalë (Nachova and Others v. Bulgaria [GC], nos. 43577/98 и 43579/98; Timishev v. Russia, nos. 55762/00 и 55974/00; D.H. and Others v. the Czech Republic [GC], no. 57325/00).

Së këtejmi, me rëndësi është të potencohen dy momente: së pari, mbi bazë të të drejtës vendase përcaktohet se cilat prova janë të lejuara dhe së dyti, rregulla e bartjes së barrës së provës, në parim, nuk zbatohet në sferën e të drejtës penale ku shteti i ndjek kryerësit e veprave penale, të cilat janë nxitur nga motive raciste. Kjo, meqë aplikohet standard i ndryshëm i dëshmimit gjatë përcaktimit të përgjegjësisë penale nga njëra anë dhe për shkak se është e papranueshme të kërkohet që kryerësi të dëshmojë se ai/ajo nuk kanë qenë të nxitur nga motive diskriminuese. Kështu, në lëndën Nachova and Others v. Bulgaria (2005), Këshilli i Lartë Gjyqësor është deklaruar: “qasja e këtyre do të thotë të kërkohet që nga shteti i paditur të dëshmojë mosekzistim të qëndrimi të caktuar subjektiv nga ana e personit në fjalë.”

Së këtejmi, është e qartë se principi affirmanti incumbit probation, përkatësisht ai i cili pohon diçka duhet edhe ta dëshmojë atë, nuk zbatohet në mënyrë rigoroze në procedurën e përcaktimit të diskriminimit.

“Në rrethana të caktuara, kur ndodhi konkrete tërësisht ose në pjesë të madhe janë të njohura vetëm për autoritetet, barra e provës mund të konsiderohet se bie mbi autoritetet të cilat duhet të sigurojnë justifikim të kënaqshëm dhe të bindshëm“ (D.H. and others v. the Czech Republic).

Ekzistimi i paragjyqimit, ose qëllimi për të diskriminuar nuk duhet të dëshmohet. Pastaj, nuk duhet të dëshmohet se një rregull ose praktikë e caktuar e sjelljes (tek diskriminimi i tërthortë) është me qëllim që të rezultojë me diskriminim. Kjo do të thotë se madje edhe në situatën një masë të jetë aprovuar dhe të zbatohet me qëllim që të jep rezultate pozitive, nëse e njëjta gjeneron rezultate të cilat janë të dëmshme për një grup të caktuar, në rast të këtyllë mund të ekzistojë diskriminim. Si ilustrim, në lëndën D.H. and Others v. the Czech Republic Qeveria ka theksuar se sistemi i shkollave speciale ka pasur për qëllim t’u ndihmojë fëmijëve romë në mënyrë që t’i tejkalojnë vështirësitë të cilat janë shfaqur për shkak të nivelit të ulët të zotërimit të gjuhës çeke dhe sistemit të dobët të arsimit parashkollor. Megjithatë, Gjykata ka konstatuar se është irelevante nëse politika e tillë është drejtuar kundër fëmijëve romë. Ajo që ka qenë e rëndësishme është të përcaktohet se ekzistojnë pasoja negative disproporcionale për romët, duke e pasur parasysh përqindjen e pjesëmarrjes në popullsinë e përgjithshme, e jo se a ka ekzistuar qëllimi që ata të diskriminohen.

Bibliografia:

- Ligji për mundësi të barabarta të meshkujve dhe femrave, “Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 6/12
- Ligji për Avokatin e Popullit, “Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 60/03
- Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, “Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 50/10
- Raporti në hije për antidiskriminim, Qendra për Hulumtim dhe Krijimin e Politikave
- Implementimi i barazisë gjinore në punën sociale përmes edukimit. Enti Republikan për Veprimtari Sociale
- Kodi Penal i RM-së, “Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 37/96, 80/99, 48/01, 4/02, 16/02, 4 3/03, 19/04, 81/05, 50 /06, 60/ 06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 142/12 dhe 166/120
- Lilla Farkash dhe Simeon Petrovski, Manual për trajnimin e gjyqtarëve për legjislacionin antidiskriminues, Misioni i OSBE-së në Shkup, viti 2012;
- Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, viti 1950
- Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - [http://www.echr.coe.int/ECHR/EN/Header/Case-Law/Decisions+and+judgments/HUDOC+database](http://www.echr.coe.int/ECHR/EN/Header/Case-Law/Decisions+and+judgments/HUDOC+database;);
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë “Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 52/1991

